Rruga e Arbërit

Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti II i Botimit. **Nr. 11(19). Nëntor 2007** Çmimi: **50** lekë, **20** dinarë

Presidenti jep mbështetje të plotë për Rrugën e Arbërit

Shpallen fituesit për dy lotet e segmentit Bulqizë - Ura e Cerenecit

TOPI*: Të rikthesh në vitin 2007 atë rrugë që ka ekzistuar historikisht, është minimumi që duhet të bëjë përfaqësuesi i popullit në parlamentin shqiptar. Kjo rrugë ka filluar të marrë trajta konkrete. Tani do të futet në fillim të vitit edhe projekti teknik për segmentin Bulqizë-Tiranë dhe unë mendoj atë që ne kemi shprehur si një dëshirë, që Peshkopia dhe Tirana të lidhen brenda një kohe shumë të shkurtër, ku njerëzit të kenë mundësi të lëvizin pa asnjë lloj problemi në mëngjes dhe në darkë. Një këshillë për përfaqësuesit tuaj që vijnë nga Dibra në institucionet kryesore, të gjithë atyre që kanë një përgjegjësi shtetërore, të gjithë intelektualëve, të cilët duhet të bëjnë lobing për zhvillimin strategjik të kësaj zone, që në bashkëpunim me institucionet vendore të bëjnë një projekt kompleks për zhvillimin e Dibrës"*

FAQE 3



"ODA DIBRANE", institucion i folkut shqiptar

FAQE 4

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE

Qari i madh në Shumbat!

Nga NAIM PLAKU - *Faqe 11*

A KA BURRA TA MBROJNË FLAMURIN SHQIPTAR?!

Vendimi i turpshëm, djallëzor, antidemokratik dhe antishqiptar i Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë, i publikuar ditë më parë, me të cilin shqiptarëve në Maqedoni u ndalohet e drejta që Flamurin Kombëtar Shqiptar ta përdorin në mënyrë të përhershme, jehoi si shpërthim i fuqishëm bombe në opinionin shqiptar në Maqedoni dhe kudo që frymon shpirt shqiptari.

Ndalimi i përdorimit të Flamurit Kombëtar Shqiptar në Maqedoni është edhe një dëshmi e papjekurisë kushtetuese, politike dhe e demokracisë së brishtë në këto hapësira.

Arsyetimet dhe kërkesa e disa partive politike maqedonase dhe e disa deputetëve maqedonas për të ndryshuar pamjen e Flamurit Kombëtar Shqiptar janë sa qesharake, aq irrituese dhe aspak të pranueshme për popullin shqiptar.

Maqedonasit, që nga Akademia e Shkencave e Maqedonisë e deri te partitë politike dhe deputetët në parlament, në forma të ndryshme dhe skajshëm primitive, në vazhdimësi mundohen ta njollosin dhe tjetërsojnë Flamurin Kombëtar Shqiptar.

Maqedonasit nuk duan ta kuptojnë se Flamuri Kombëtar Shqiptar nuk është ideologji, por ai është shpirti i shqiptarëve, është forca goditëse për të luftuar të keqen, është simboli i guximit dhe i vetëflijimit që u dëshmua ndër shekuj me shembuj konkretë pozitivë për vetë popullin shqiptar dhe për tërë fqinjët e tij, duke përfshirë edhe maqedonasit, të cilët u ndihmuan me sakrificën dhe gjakun e shqiptarëve kundër armiqve të përbashkët.

Flamuri Kombëtar Shqiptar është një, ai nuk mund të ndryshohet e tjetërsohet me asfarë shenjash dekadente.

Rryma joshqiptare dhe antishqiptare që ekziston rreth përdorimit të Flamurit Kombëtar Shqiptar duhet ta kuptojë njëherë e përgjithmonë se flamuri shqiptar nuk ka aspak të ngjarë me simbolet maqedonase, me ato turke, me ato serbe dhe as me ato boshnjake. Për të vetmen arsye se shqiptarët nuk janë ardhacakë këtu, por janë denbabaden në trojet e veta etnike, e para. Dhe e dyta, se Flamuri Kombëtar Shqiptar ka një jetëgjatësi më shumë se 600 vjeçare, i kalitur dhe i skuqur nëpër flakët e betejave shekullore të kombit shqiptar për liri, që nga Skenderbeu dhe prijësit e mëvonshëm. Është flamuri që i kënduan plot lavd Naim Frashëri dhe shumë poetë tjerë. Është flamuri domethënës për të cilin kanë dhanë jetën mijëra e mijëra shqiptarë dhe për të cilin janë në gjendje të sakrifikojnë në çdo moment edhe shumë shqiptarë të tjerë.

Vetë fakti edhe i caktimit të dozave matematikore për përdorimin e Flamurit Kombëtar Shqiptar në Maqedoni sipas përbërjes së popullatës, nuk ishte gjë tjetër veçse denigrim i dinjitetit shqiptar, i urtësisë shqiptare dhe i paaftësisë së lidershipit shqiptar që të mbrojë edhe një të vërtetë të pastër si loti. Trojet shqiptare janë të njohura në histori. Ato janë kafshuar dhe shterrur vazhdimisht nga armiqtë shekullorë. Aty ku ka 20 përqind shqiptarë, nuk e luan as topi se shqiptarët janë në trojet e tyre etnike, ndaj për përdorimin e flamurit kombëtar nuk duhet të vlejë asfarë numri matematikor.

Meqë Flamuri Kombëtar Shqiptar është simbol shumëshekullor, është fare e papranueshme që atij t'i ngjiten copa shenjash e leckash karnevalesh, siç pretendojnë disa parti dhe deputetë maqedonas, sa për të kënaqur apetitet e tyre të sëmura shovene.

Për të qenë prijës partiak, deputet, ministër apo gjykatës i mirëfilltë, nuk mjafton vetëm të jesh në krye të partisë, të ulesh në sallën e parlamentit apo në zyrën e ministrit apo të gjykatësit. Këto profesione kërkojnë përgjegjësi, dituri, guxim, urtësi dhe aftësi të madhe për të hecur para, që për fat të keq nuk i kanë të gjithë prijësit partiakë, deputetët, ministrat dhe gjykatësit tanë.

Mungesa e këtyre vetive te pjesa më e madhe prijësve partiakë, e ministrave, deputetëve dhe gjykatësve tanë, i bën të jenë të ç'armatosur dhe oportunistë gjatë debateve publike, në vetë parlamentin dhe gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si ministra apo si gjykatës.

Mbrojtja e Flamurit Kombëtar Shqiptar kërkon mençuri, trimëri e sakrificë.

Nuk mund ta mbrojnë Flamurin Kombëtar Shqiptar ata që shohin vetëm interesin vetjak, ata të cilët nuk janë në gjendje që në çdo moment ta sakrifikojnë postin partiak, të deputetit, të ministrit apo të gjykatësit.

Se a do të dijnë ta mbrojnë Flamurin Kombëtar Shqiptar prijësit partiakë, deputetët dhe funksionarët tanë shqiptarë do të tregojë koha. Por vetëm një gjë është e qartë, se ai që nuk di ta mbrojë Flamurin Kombëtar Shqiptar, nuk meriton as të quhet shqiptar.

Rexhep TORTE

Dekorohet Edip Tërshana me "Medaljen e Artë të Shqiponjës"

FAQE 2

Nënshkruhet Karta e Vëllazërimit mes Dibrës së Madhe dhe Gjakovës

FAQE 2

Copëza kujtimesh me profesorin dibran të gjeologjisë, Bashkim Lleshi

NGA VESEL HOXHA

FAQE 6-7

Semiotika e dasmës shqiptare

(në variantin e Dibrës)

NGA AGRON TUFA

FAQE 8

MA NDEZE MALLIN, OR BENI I ILNICËS

NGA ABDURRAHIM ASHIKU

FAQE 10

Homazh për Ilmi Latën

FAQE 11

Adresa e redaksisë: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë. Tel.068 31 19 232. E-mail: Lid_gazeta@yahoo.com. www.dibra.org

Dekorohet Edip Tërshana me "Medaljen e Artë të Shqiponjës"

Gjatë vizitës së tij në qytetin e Peshkopisë ku qe i pranishëm edhe në Odën Dibrane, në një ceremony të veçantë dhe takim me intelektualët e qytetit lindor, Presidenti i Republikës zoti Bamir Topi dekoroi me propozim të Bashkisë së Peshkopisë Edip Tërshanën(pas vdekjes) me "Medaljen e Artë të Shqiponjës" Në këtë ceremoni që u zhvillua në Pallatin e kulturës "Haki Stërmilli" merrnin pjesë familjarë e miq si dhe intelektualë e qytetarë të tjerë të qytetit të Peshkopisë.Në këtë takim u kujtua Edip Tërshana, puna e tij për hapjen e shkollave shqipe në Dibër të Madhe që në vitet 40, dhe idetë e tij për të drejtën e qytetarëve të Kosovës për vetvendosje dhe orientimin perëndimor të Shqipërisë për të cilat u pushkatua nga pushteti i kohës në vitin 1948.

Presidenti i Republikës i ka dorëzuar djalit të Edip Tërshanës, Medatit "Medaljen e Artë të Shqiponjës" me motivacionin "Në shenjë nderimi të thellë për jetën dhe veprën e tij në shërbim të çështjes kombëtare dhe të fitores së vlerave të demokracisë, duke u vendosur përjetësisht në panteonin e martirëve të mëmëdheut".Në fjalën e tij Presidenti Topi ndër të tjera tha:-Jam i bindur që rikthimi në memorje i kësaj figure të nderuar, në radhë të parë, na bën nder të gjithëve, u bën nder brezave për të treguar se historia nuk bëhet një ditë, historia shkruhet nga brezat dhe një nga pjestarët e një brezi, i cili bëri të mundur që të vijnë këto ditë të një demokracie ndoshta të brishtë, por të lirë, është i paharruari Edip Tërshana. Edhe në këtë ceremoni Presidenti shoqërohej nga ministri i jashtëm zoti Lulzim Basha, zv ministrja e Kulturës zonja Suzana Turku, kryetari i Bashkisë së Peshkopisë zoti Ilir Krosi si dhe deputet të Kuvendit popullor.

Edip Tërshana lindi më 1907 në Dibër, në familjen e Tërshanajve, duke gjetur në këtë mënyrë shtratin e duhur ku do të formohej karakteri dhe personaliteti i tij i mëvonshëm.

Më 1928, me interesimin e patriotëve dibranë, përfundon me rezultate të shkëlqyera Normalen e Elbasanit, përvetëson italisht, frëngjisht, persisht dhe serbokroatisht. Më 1929-1930 punoi si mësues në shkollën e Shijakut. Në vitet 1930-1936 drejtor i shkollës "Hoxha Tahsim" në Tiranë dhe në vitet 1936-1940 drejtor i shkollës Nr.1 të Durrësit. Pas vitit 1941 emërohet kryeinspektor arsimi në Dibër të Madhe, detyrë të cilën e kreu në mënyrë të shkëlqyer. Gjatë kësaj kohe ai dhe një ndihmesë tepër të çmuar në hapjen e shkollave shqipe në Rekë, Dibër, Tetovë, Gostivar dhe Strugë, duke materializuar në këtë mënyrë tezën se: "Një popull të arsimuar e të ditur nuk mund ta mbash për një kohë të gjatë në skllavëri". Në Dibër ai zhvillon një veprimtari shumëplanëshe. Lufën kundër pushtuesve nazifashiste nuk e ndante nga rreziku potencial i armikut shekullor shumë të rrezikshëm dhe gjithmonë të pranishëm atij serbo-



sllav, i cili për fatin tonë të keq në atë kohë ishte kamufluar në formën e komunizmit sllav, duke depërtuar ndjeshëm edhe në Lëvizjen Antifashiste. Ai qe ndër të paktët intelektualë të kohës që idealet e luftës antifashiste përpiqej t'i harmonizonte me idealin kombëtar, duke i dhënë kësaj të fundit, rëndësi parësore.

Në vjeshtën e vitit 1942 në shtëpinë e Medat Tërshanës formohet Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtare, kryetar i të cilit zgjidhet Edip Tërshana. Me 9 shtator 1943 dita e kapitullimit të Italisë fashiste, ngre flamurin shqiptar në Dibër. I alarmuar vjen me shpejtësi Vukmanoviç Tempo që kërkonte uljen e flamurit shqiptar dhe ngritjen e atij maqedonas. Zhvillohet kështu një polemikë e debat i ashpër mes tyre dhe në fund arrihet një kompromis i përkohshëm, të ngrihen të dy flamujt deri në mbajtjen e një plebishiti pas lufte. Profesor Masar Kodra, në shkrimin "30 vjet nga formimi i territoreve të lira" shkruan se Edipi këmbëngulte në përbërjen pluraliste të këshillit, gjë që kundërshtohej nga organizata partiake dhe nga shtabi i batalionit të Dibrës. Kështu që në zgjedhjet e mëvonshme, makinacionet sllavo-komuniste e shmangën Edipin nga detyra e kryetarit dhe ia arritën qëllimit për ta nxjerrë jashtë këshillit, pasi një gjë e tillë do të ngjallte reagim te populli trim e liridashës dibran, që për shkak të respektit që kishte për të, ia kishte refuzuar atij disa herë kërkesën për dorëheqje, të cilën Edipi e kishte bërë si rrjedhojë e grindjeve në organizatën partiake. Në këtë kohë, disa njerëz me qëllime keqdashëse ose ngaqë nuk e kuptonin, e kishin akuzuar Edipin për komunist. Më shumë se atë herë kurrë nuk e pati ndjerë veten më të fyer, sepse e ndjente kundërshtinë që ekzistonte midis intelektualëve të vërtetë dhe të qenit komunist. Për këtë i bën një letër Mehdi Frashërit, me 27 dhjetor 1943, ku në mes të tjerash i shkruan: "Tu e pasur bindje të plotës se veprimtaria jonë ka qenë në drejtim nacionalist dhe në mbrojtje të interesave kombëtare, ju sigurojmë se akuza e bame ka shkaktue ndër ne një deziluzion të vërtetë dhe për konsekuencë një rënie të madhe shpirtërore, por duke e pasur gjithmonë besimin e ngulur me qëllimin e mirë të veprimeve tona, paraqitemi para shkëlqesisë suaj sikurse i paraqitem Kryesisë së Parlamentit Shqiptar si dhe autoriteteve tona direkte për të vënë në dukje veprimtarinë tonë e në qoftë se kjo veprimtari ka me u gjykue tradhti para kombit, jemi gati të sakrifikohemi për idealin kombëtar, mjafton që të mos quhem komunist".

Pas katër vjetësh kjo letër bashkë me të tjera të mëvonshme do të shërbenin si prova kryesore të akuzës kundër Edip Tërshanës dhe do t'i falnin kënaqësi sadiste kriminelit famëkeq Gjysh Tafilit.

Në fillimin e vitit 1944 thellohet analiza që Edipi i bën luftës antifashiste, duke u bërë i vetëdijshëm për rrezikun sllav që i kërcënohej popullit të Dibrës. Për këto arsye Edipi fillon lidhjet me elementet më nacionaliste në Dibër, Tetovë, Shkup për t'i ndërgjegjësuar ata për luftën që do të bënin. Në këtë kohë ai kërkoi lidhje edhe me Mehdi Frashërin, Fiqiri Dinen, duke parë tek ata figura të spikatura nacionaliste. Në fillimin e vitit 1944 shkon pranë dajës së tij Qamil Ballanca dhe me 4 shkurt 1944 lufton kundër masakrës, duke shpëtuar shumë familje, ndër të cilat edhe prindërit dhe motrën e diktatorit të ardhshëm gjakatar E. Hoxha, gjë për të cilën ia shpërbleu me jetën e tij. Me 1945 Edipi shkon në Peshkopi dhe në vitin 1945-1946 bëhet drejtor i të parës shkollë unike të Peshkopisë.

Në vazhdim të opsioneve të tij politike, Edipi nuk mund të prananonte veprën makabre që përpiqej të vendoste në Shqipëri E. Hoxha. Ai kontakton që në atë kohë me partitë e ndryshme opozitare që po krijoheshin në ilegalitetin e Tiranës, po nuk merr pjesë në to dhe ëndërronte të formonte Partinë Demokratike Shqiptare. Regjimi i E. Hoxhës për të realizuar strategjinë e tij antikombëtare dhe antinjerëzore vendos që të asgjësojë trurin e kombit shqiptar, inteligjencën shqiptare, sidomos ata që ishin shkolluar në perëndim.

Pasi përpunuan në detaje në bashkëpunim me titistët jugosllavë, filluan të vinin në zbatim gjenocidin më ë ashpër në historinë e njerëzimit kundër inteligjencës së një populli. Kështu, që në fillim të vitit 1946 fushata kundër tyre do të njihte kulme dhe brenda disa ditëve me dhjetëra dhe qindra intelektualë shqiptare do t'u nënshtroheshin torturave më të tmerrshme, deri në likuidimin e tyre fizik.

Lavdërim Shehu

DIBËR E MADHE - U nënshkrua Karta e Vëllazërimit mes Dibrës së Madhe dhe Gjakovës

Të vëllazëruar të ecim përpara

Në seancën solemne të datës 7 nëntor 2007 të Këshillit të Komunës së Dibrës, ku përveç këshilltarëve merrnin pjesë edhe Argëtim Fida, kryetar i Komunës së Dibrës së Madhe dhe Aqif Shehu, kryetar i komunës së Gjakovës-Kosovë me bashkëpunëtorët e tij Zoge Gacaferi, Anton Shala dhe Xhevat Rraci, u nënshkrua Karta e Vëllazërimit ndërmjet Komunës së Dibrës dhe Komunës së Gjakovës.

Ky akt nënshkrimi u krye mbi bazën e interesit dhe dëshirës së përbashkët në zhvillimin e bashkëpunimit mes këtyre dy komunave, mbi bazën tradicionale të bashkëpunimit dhe të mundësive të pashterrshme, që inicojnë e nxisin shpirtin e miqësisë së vërtetë në të gjitha fushat që bashkarisht të hapërojnë drejt ardhmërisë dhe prosperitetit.

Me këtë rast u nënshkrua edhe Protokolli për Bashkëpunim mes këtyre dy komunave, ku thuhet se Dibra e Madhe dhe Gjakova, do të punojnë në krijimin e kushteve më të mira për bashkëpunim të ndërsjellë mes afaristëve, ndërmarrjeve publike, enteve kulturore, OJQ-ve dhe të gjitha organizatave dhe individëve të interesuar. Do të realizohen aktivitete të përhershme re-



ciproke për njohjen e historisë, kulturës e traditës, marrëdhënie ekonomike e tregtare, shkëmbim përvojash në vetëqeverisjen lokale dhe vizita të ndërsjella delegacionesh dhe ekpërtësh, do të vendosen lidhjeve miqësore mes shkollave të këtyre dy komunave për organizimin e takimeve kulturore, arsimore e sportive , si edhe shkëmbime informatash për bashkëpunim edhe në fushën e turizmit.

Argëtim Fida, kryetar i Komunës së Dibrës së Madhe me ketë rast, u shpreh se: "Ndjehemi krenarë që pas periudhave dhe peripecive të vështira që kaloi kombi ynë deri sot, erdhi dita që bashkërisht të grumbullojmë forcat, të shkëmbejmë përvojat, të rindërtojnë atë që rënuan luftërat, që kufijtë të mbeten vija në hartat gjeografike të imponuara nga Berlini, Londra e Parisi. Sot kur tërë kombi ynë i ka drejtuar sytë kah Kosova, kur pret dhe është bashkërenditur në kërkesën unanime se për shqiptarët veç pavarësisë asnjë zgjidhje tjetër nuk është e pranueshme. Sot dëshmojmë që edhe Maqedonia është e bashkërenditur me këto forca për zgjidhjen e kësaj nyje të gordit në Bllkan dhe që bashkërisht ky rajon të ecë para me stabilitet politik, me zhvillim ekonomik dhe me aderim në strukturat euroatlantike dhe në Evropën e Bashkuar. Kjo lidhje shpirtërore, ky vëllazërim i sotëm mes dy qyteteve tona, që kanë qenë të lidhur me shekuj sa herë e ka kërkuar kushtrimi, sot dëshmojmë që bashkërisht dhe me urtësi të kontribuojmë në zgjidhjen e çështjeve madhore".

Aqif Shehu, kryetar i Komunës së Gjakovës, deklaroi se: "Qyetet tona me shekuj mbajtën gjallë shenjën tonë përmes penës e pushkës, diplomacisë e bashkëpunimit me të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë. Ne shqiptarët mund të jetojmë edhe me popuj të tjerë, sepse jemi popull fisnik e human, popull patriot dhe internacional. Me dinjitet mbajtëm peshën e ëndë kombëtare, duke mos u përkulur kurrë para armiqve të shumtë që i patëm gjatë historisë sonë të dhimbshme, por të lavdishme të shkruar me gjakun e bijave e bijve të kombit, gjë që rezultoi që ne sot shqiptarët e trojeve tona të ulemi në sofrën e madhe ku flasim për lashtësinë dhe krenarinë tonë, sakrificën dhe kurorëzimin e përbashkët me fitore. Gjakova u sjell urimet dhe përshëndetjet më të përzemërta për të vazhduar bashkëpunimin tonë në tërë sferat e jetës, për të krijuar një botë të vogël pa kufi, një botë demokratike ku ka vend për të gjithë".

Me këtë rast u shkëmbyen edhe pllaketa, vepra artistike të dy komunave të vëllazëruara.

Rexhep TORTE

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: **RAKIP SULI.** Kryeredaktor: **SHAQIR SKARRA.**
Redaksia: **Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Prof. Dr. Shaban Sinani, Bujar Karoshi, Rexhep Torte, Dukagjin Hata, Dr. Hasan Leka, Mirvet Lala,**
ADRESA E GAZETËS: **Blloku i banesave "Gintash", market "KEN", Laprakë.**
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179. E-mail: **lid_gazeta@yahoo.com**

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin qëndrimin e redaksisë dhe Shoqatës "LID".

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë",
PROCREDIT BANK. Nr. Llog: Në lek 13-661344-0001.
Euro 13-661344-0102. USD 13-661344-0203.

Segmenti i Rrugës së Arbërit, ja projekti teknik

(Vijon nga numri i kaluar)

1.21 Shenjat dhe kuotat do te caktohen si bazat e matjes

Kontraktori do te pergjigjet per piketimin e aksit te rruges dhe per caktimin e gjurmes fillestare dhe kuotave te rruges.

Kontraktori do te vendose piketa te perkohshme ne intervale pergjate rruges te cilat nuk do t'i kalojne 200 metrat, si edhe do t'i jape Supervizorit tabelen e kuotave te tyre.

Kontraktori do te caktoje aksin dhe kuoten e rruges, si edhe pjesen e siperme ne germim dhe fundin e mbushjes ne intervale te tilla qe nuk duhet te kalojne 50 metra apo intervale te tilla me te shkurtra ne kthesa horizontale dhe vertikale sipas kerkeses.

Perpara fillimit te punimeve apo te nje pjese te tyre, Kontraktori dhe Supervizori se bashku do te kontrollojne dhe masin kuotat e vendit ku do te kryhen Punimet dhe do te bien dakord mbi te gjithe vecorite mbi te cilat do te bazohen ne matjen e Punimeve. Keto rilevime topografike do te rregjitstrohen dhe firmosen nga Supervizori dhe Kontraktori dhe do te jene baza e matjes per certifikata e supervizorit. Ne rast se keto rilevime topografike dhe arranxhime nuk firmosen nga Kontraktori, matjet topografike te firmosura nga Supervizori do te jene perfundimatre dhe te detyrueshme per Kontraktorin. Keto rilevime topografike do te jene ne dy kopje, nje kopje per Kontraktorin dhe nje kopje per Supervizorin.

1.22 Dimensionet dhe kuotat

Kontraktori duhet te verifikoje ne Kantier dimensionet, distancat, kendet dhe ngritjet (mbushjet) qe tregohen ne Vizatimet e projektit si edhe cdo vecanti tjeter qe eshte pjese e Kontrates. Ne rast se zbulohet ndonje mosperputhje midis vlerave te dhena ne Vizatimet e projektit dhe atyre te Kantier te cilat mund te ndikojne ne ndonje pjese te Punimeve, Kontraktori duhet te njoftoje Supervizorin ne kohen e duhur per t'i dhene Supervizorit mundesi te aprovoje Vizatimet e projektit te Kontraktorit ku tregohen vlerat dhe sasite shtese perpara fillimit te punimeve.

1.23 Ruajtja e shenjave topografike

Kontraktori duhet te gjeje dhe aty ky eshte e mundur te ruaje apo edhe t'i rivendose te gjitha shenjat topografike. Ne ato raste kur shenjat topografike do te shkaterohen, Kontraktori do t'i referoje ato me saktesi ne shenjat topografike te perhershme prej betonin perpara fillimit te punimeve. Te gjitha keto do te behen me shpenzimet e Kontraktorit.

Gjate progresit te Punimeve, Kontraktori nuk do te heqe, demtoje, ndryshoje apo shkaterroje ne asnje rast cdo rilevim topografik te rrjetit shteteror. Nese Kontraktori mendon se do te kete nderhyrje ne rjetin topografik shteteror me Punimet e tij, ai do te njoftoje Supervizorin i cili ne rast se e sheh te nevojshme do te marre masat per heqjen dhe zevendesimin.

1.24 Tipi i terrenit dhe Kushtet e Punes

Kontraktori duhet te pershtatet me kushtet e pergjithshme te Kantier te Punimeve dhe te ndertimit atje, me formen e shtratit te lumit dhe brigjeve, rrjedhjet e lumit, siperfaqen e terrenit dhe llojin materialeve qe do te germohen, mundesine e renies nga terren i bute ne terren te keq dhe materialet e thyera dhe renien e shkembinjve gjate Punimeve, mundesine e vershimeve te permbytjeve, shkarrjeve te tokes. Ne preventiv do te parashikohen disa vlera dhe çmime njesi rezerve per te mbuluar keto raste.

Drenazhimi i tokes natyrale ne afersi te vendit ku kryhen punime dheu, dhe ne pergjithesi punimet e drenazhimit do te behen perpara te gjitha Punimeve te tjera.

1.25 Vizatimet e punes

Perpara se te fillojne Punimet apo cdo pjese e tyre, Kontraktori duhet te pergatise dhe dorrezoje per aprovimin e Supervizorit kopjet (ne rastin me te pare) te cfaredo Vizatimi Pune te detajuar qe mund te kerkohet per ate pjese te punes dhe ne te njejten kohe t'i terheqe vemendjen Supervizorit per diferencat qe mund te ekzistojne midis tyre dhe Vizatimeve te projektit sipas Kontrates. Supervizori, pasi Kontraktori te kete bere ndryshimet qe mund t'i kerkoje ai, do te rregjistroje ne kopjet e ndryshuara aprovimin e tij dhe do t'i ktheje nje kopje Kontraktorit qe do te zhvilloje punimet sipas ketyre ndryshimeve te aprovuara.

Kontraktori do t'i jape Supervizorit kater kopje te tjera te Vizatimeve te aprovuara te Punes. Pervec kesaj, duhet te dorrezohen edhe Vizatimet e Punes (do te ndiqet e njejta procedure qe pershkruhet me siper) ne lidhje me cdo pune qe propozohet te kryhet nga nen-kontraktoret. Aprovimi nga Supervizori i te gjitha Vizatimeve apo pjeseve te tyre nuk e çliron Kontraktorin nga pergjegjesia e kryerjes se punimeve.

1.26 Vizatimet e Planimetrive dhe Profilave

Kontraktori do t'i paraqese per aprovim Supervizorit te gjitha vizatimet e plota te detajuara te planimetrive dhe profilave te seksioneve te rruges ne te cilat ai do te punoje. Keto vizatime duhet te tregojne kuoten e tokes natyrale dhe kuoten sipas projektit te aksit te rruges, mbingritjen e aneve te rrugeve, te dhenat ne lidhje me gjurmen ne planin vertikal dhe horizontal dhe te gjitha detajet e tjera qe mund te kerkohen nga Supervizori.

Kuota terthore e rruges, ne perputhje me kushtet e tjera te vendit ku ajo kalon, duhet te minimizoje volumin e levizjeve te dheut (mbushje/germim).

1.27 Ndryshimi i Vizatimeve te projektit

Ne te gjitha rastet kur per vizatimet specifikohet apo kerkohet te dorezohen nga Kontraktori per aprovimin e Supervizorit, cdo ndryshim ne keto Vizatime qe mund te kerkohet nga Supervizori do te behet nga Kontraktori pa asnje kosto shtese.

1.28 Paraqitja e Vizatimeve te Punimeve te Paparashikuara

Kontraktori duhet t'i paraqese Supervizorit per aprovim, Vizatimet e plota te Punimeve te Paparshikuara qe kerkohen per kryerjen e Punimeve, se bashku me llogaritjet qe lidhen me qendrueshmerine dhe devijimet e pritshme te tyre.

Vizatimet duhet te tregojne metoden e propozuar per realizimin e zerave te ndryshem te Punimeve te Paparashikuara dhe aplikimin e tyre ne kryerjen e Punimeve te Perhereshme.

Te gjitha Punimet e Paparshikuara duhet te projektohen sakte dhe te ndertohen, mire per te mbajtur ngarkesat per te cilat jane logaritur. Te gjitha Vizatimet dhe llogaritjet qe lidhen me to do t'i jepen Supervizorit ne kohe per t'i studjuar me kujdes dhe per te perfshire modifikimet qe mund te kerkoje Supervizori.

Pavaresisht nga aprovimi apo modifikimet qe do te behen nga Supervizori per cdo vizatim te paraqitur per cfaredo Punimi te Paparashikuar, Ndarjet ne Faza etj, Kontraktori do te jete plotesisht pergjegjes deri ne realizimin e ketyre Punimeve, per efiçiencen, sigurine dhe mirembajtjen e tyre, si edhe per te gjitha detyrimet dhe rreziqet qe lidhen me Punimet e specifikuara apo te nenkuptuara ne Kontrate. Kontraktori duhet t'i ruaje ne te njejten gjendje sa me siper, dhe ne rast aksidenti apo prishjeje qe mund te shkaktoje demtim apo plagosje, ai do te pergjigjet vete sipas dispozitave te Kushteve te Kontrates qe mund te aplikohen ne raste te demtimeve apo plagosjeve te tilla.

Dy kopje te secilit prej Vizatimeve do t'i dorezohen Supervizorit menjehere dhe ai do te rregjistroje ne keto kopje, te cilat jane ndryshuar dhe modifikuar sipas kerkeses, aprovimin e tij dhe do t'i ktheje nje kopje Kontraktorit i cili pastaj mund te vazhdoje ne perputhje me to. Kontraktori do t'i jape Supervizorit kater kopje te tjera te Vizatimeve te aprovuara.

Kostoja e plotesimit te te gjitha kerkesave te kesaj Klauzole do te perballohet nga Kontraktori.

1.29 Sherbimet ekzsituese (Utilitetet)

Kontraktori do te njihet me pozicionin e te gjitha sherbimeve ekzistuese, si kanalet kullues, linjat dhe shtyllat telefonike dhe ato te elektrikut, linjat e ujesjelesit, tubat etj, perpara se te filloje punimet per germimin, mbushjen apo ndonje pune tjeter qe mund te ndikoje ne sherbimet ekzistuese.

Kontraktori do te pergjigjet per aranaxhimin e heqjes apo spostimit te ketyre sherbimeve ne lidhje me dhe sipas specifikimeve te Autoriteteve perkatese, pas marreveshjes me Supervizorin dhe kur kerkohet nga Punimet.

Heqja apo ndryshimi i sherbimeve ekzistuese do te jete e programuar me kohe dhe duhet te jete e hartuar ne avance per te marre aprovimin me shkrim te Autoriteteve perkatese perpara fillimit te punimeve.

Ne ato vende ku puna behet ne afersi te linjave ajrore te tensionit te larte, Kontraktori eshte pergjegjes per t'u siguruar qe te gjithe personat qe punojne ne keto zona te jene te instruktuar qe afersia relative e vincave apo mjeteve te tjera metalike me keto linja shkaktojne lidhje te shkurter elektrike dhe tokezim.

Kontraktori do te jete pergjegjes per demtime ne punimet apo sherbimet ekzistuese dhe do t'i kompensoje Punedhenesit cfaredo kerkese te tij per kompensim ne kete drejtim.

Kujdes i vecante duhet bere per rimbushjen per kompaktimin e tokes nen tuba, kabllo etj. dhe per te mos mbuluar matesat e ekspozuar te ujit dhe saracineskat.

Kostot e ketyre punimeve qe nuk perfshihen ne preventiv si nje artikull i vecante apo qe nuk paraqiten ne vizatimet e projektit jane te perfshira ne Shumat e Punimeve te Paparashikuara ne avance.

1.30 Njoftimi per operacionet e Punes

Kontraktori do te njoftoje me shkrim ne menyre te plote dhe komplete Supervizorin per te gjitha veprimtarite qe ai do te ushtroje. Ky njoftim duhet te behet me kohe per t'i dhene mundesi Supervizorit te beje arranxhimet e duhura qe ai mund t'i konsideroje si te nevojshme per inspektim apo per cfaredo qellimi tjeter. Kontraktori nuk do te filloje asnje veprimtari te rendesishme pa marre me pare aprovimin me shkrim te Supervizorit.

1.30 Fotografite

Kontraktori me shpenzimet e tij duhet t'i paraqese Supervizorit negativet dhe 3 kopje te stampuara te ecurise se punimeve te marra ne intervale nje-dy mujore, me permasa jo me pak se 180 mm me 120 mm te atyre pjeseve te Punimeve, ne progres dhe te perfunduara sic mund t'i kerkoje Supervizori. Fotografite do te jene prone e Punedhenesit dhe asnje kopje e negativave nuk do t'i jepet asnje personi apo personave pa aprovimin e Punedhenesit apo Supervizorit. Kontraktori do te siguroje albumet e fotografive dhe mbajtese per varjen/ montimin e fotografive.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Përgatiti: InfraTransProjekt Shpk
Rr. "Qemal Stafa", P.132, Ap.1, Tiranë
***Tel:** +355 4 22 56 50 Fax: +355 48 302 177*
Mob.: +355 68 20 32 609
E-mail: fkaba@icc.al.eu.org
Web: http://www.itp-al.com/



Presidenti Bamir Topi jep mbështetje të plotë për Rrugën e Arbërit

Më datën 3 nëntor, në një takim që zhvilloi Presidenti i Republikës, zoti Bamir Topi, me intelektualët e qytetit të Peshkopisë, dha një mbështetje të fuqishme për Rrugën e Arbërit, duke e konsideruar atë si një arterie mjaft të rëndësishme për zhvillimin e zonës. Ai tha: "Kam qenë një ndër ata që e kanë mbështetur, kur kam qenë në Parlament, investimin e rrugës së Arbërit. Sigurisht, nuk e kam bërë këtë për oportunizëm me dëshirën që kishin disa kolegë të mi parlamentarë.

Por, të rikthesh në vitin 2007 apo në mijëvjeçarin e tretë, atë rrugë që ka ekzistuar historikisht, është minimumi që duhet të bëjë përfaqësuesi i popullit në parlamentin shqiptar. Dhe këtë unë e kam parë tek përfaqësuesit tuaj. Besoj që jeni në dijeni se kjo rrugë ka filluar të marrë trajta konkrete. Tani do të futet në fillim të vitit edhe projekti teknik për segmentin Bulqizë-Tiranë dhe unë mendoj atë që ne kemi shprehur si një dëshirë, që Peshkopia dhe Tirana të lidhen brenda një kohe shumë të shkurtër, ku njerëzit të kenë mundësi të lëvizin pa asnjë lloj problemi në mëngjes dhe në darkë. Besoj se është një moment që të gjithë ne duhet ta përshëndesim. Unë, sigurisht, mund të trajtoja këtu tema të ndryshme, por besoj një kështillë kisha dëshirë t'ua jepja: Së pari, përfaqësuesve që vijnë nga Dibra në institucionet kryesore, të gjithë atyre që kanë një përgjegjësi shtetërore, të gjithë intelektualëve, të cilët normalisht nuk kanë pse të mos bëjnë lobing për zhvillimin strategjik të kësaj zone, që në bashkëpunim me institucionet vendore të bëjnë një projekt kompleks për zhvillimin e Dibrës. Kështu funksionon e gjithë politika edhe në vendet më demokratike".

SHPALLEN FITUESIT PËR TRE LOTET E SEGMENTIT BULQIZË - URA E CERENECIT

Pas tenderit të zhvilluar muajin e kaluar për tre lotet e segmentit dalje e Bulqizës - Ura e Cerenecit, burime nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve kanë bërë të ditur se janë shpallur fituesit e tre loteve..

Firma "Alba Via dhe "Karl Gega" janë fituesit e lotit të parë, ndërsa "Delia Group" dhe "Eurald" janë fituesit e lotit të dytë. Fituesi i lotit të tretë është firma Almo Konstruksion, etj.

"Oda Dibrane", institucion i folkut shqiptar



SHKRUAN GAZETA "FAKTI" MË DATË 5 NËNTOR 2007

Vlera të shkëlqyera folklorike shqiptare

Nga **SHAQIR SKARRA**

Edhe pse nëntori erdhi i ftohtë, qyteti i bukur i Peshkopisë ka veshur petkun e festës tradicionale të saj. Kjo atmosferë festive ndjehet kudo. Nuk i pengoi shiu dhe i ftohti karakteristik i nëntorit dibranët të dalin në shëtitoren kryesore të qytetit dhe të presin mysafirët e përvitshëm. Jo vetëm në shëtitore, por edhe ballkonet e shtëpive janë mbushur plot, ku qytetarët shikojnë mysafirët që kanë "pushtuar" për dy net me radhë qytetin e tyre.

Dibranët kanë një merak që t'i presin mysafyrët e largët sa më mirë.

E, padyshim, këtë shqetësim më shumë se kushdo e ka drejtori i festivalit, zoti Veli Vraniçi. Shqetësimi i tij është edhe tek kolegët, tek të gjithë personeli i Qendrës kulturore "Haki Stërmilli". Ky shqetësim shtohet më shumë kur merret vesh se sivjet në Odën Dibrane i pranishëm do të jetë dhe vetë Presidenti i Republikës, zoti Bamir Topi. Qyteti është i vogël dhe shpejt fjala mori dhenë. Sporteli i Qendrës kulturore u mbush plot për plot dhe biletat u shitën sa hap e mbyll sytë. Për dibranët, ardhja e Presidentit në këtë edicion të Odës Dibrane ishte një nder që i bëhej qytetit të tyre. Salla ishte e tejmbushur dhe sytë e të gjithëve ishin drejtuar andej nga do të futej zoti President. Dhe ... ora 18. Mes spektatorëve dibranë futet Presidenti, zoti Bamir Topi, ministri i Punëve të Jashtme, zoti Lulzim Basha, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, deputetë të Kuvendit si Pal Dajçi, Idriz Xhumara, Rahim Kaleci, Sali Shehu e Albert Farruku, kryetari i bashkisë, zoti Ilir Krosi, prefekti, zoti Xhafer Seiti dhe mjaft pushtetarë lokalë të Peshkopisë. Të pranishmit në sallë i përshëndeti kryetari i bashkisë, zoti Ilir Krosi, i cili falenderoi në mënyrë të veçantë Presidentin e Republikës për këtë nder që u bëri dibranëve, duke qenë i pranishëm në Odën Dibrane, e cila tashmë është bërë një traditë e bukur e folkut shqiptar.

Në skenë u ngjitën natën e parë grupet e Preshevës, Gramshit, Zhur-Kosovë, Gërnec-Vlorë, Bllacë-Shkup dhe Qendra kulturore Peshkopi.

Të pranishmit i përshëndeti dhe Presidenti i Republikës, zoti Bamir Topi.

- E prita me kënaqësi ftesën e bërë nga kryetari i bashkisë Ilir Krosi për të marrë pjesë në Odën Dibrane. Të vish tek Oda Dibrane, në radhë të parë, do të sjellësh në mendje mikpritjen dibrane, bujarinë dibrane, patriotizmin e kësaj treve të shkëlqyer dhe duke biseduar me zv ministren e Kulturës, Suzana Turku, një nga artistet e shkëlqyera që ka vendi ynë, po bënim interpretimin e skenës.Dëshiroj të vlerësoi skenografin, i cili ka ditur në pak ambient t'i mbledhë të gjitha. Këtu shohim simbolikën e kullës dibrane, që sot me kënaqësi e gjejmë në Reç, Çidhën, Lurë, Kastriot. Ju e shikoni që Oda Dibrane ka shumë dritë. Ju e dini që në këtë hapësirë midis dy kullave dibrane ka vend për të gjithë, ajo është mikpritja dibrane. Në këtë qilim, në fakt, është i gjithë arti dhe talenti i artizaneve dibrane, ku kombinohet arti me simbolikën e të gjitha simboleve kombëtare. Këtu i gjen të gjitha, kjo është arsyeja që Oda Dibrane është një institucion më vete, është vazhdimi i nëntë maleve të Dibrës, që ishin një institucion më vete.

Më vjen mirë që ky edicion i trembëdhjetë, sot bashkon shqiptarët që vijnë nga vise të ndryshme. Ky është një mesazh i mrekullueshëm. Këtu, përveç kostumeve, instrumenteve, këngëve dhe valleve burimore, ne shohim se si bashkohen zemrat e shqiptarëve kudo që janë, në momente mjaft të rëndësishme të historisë së popullit tonë. Le të fitojë sonte më i miri, por unë jam i bindur se do të fitojë Oda Dibrane, do të fitojë vëllazërimi midis shqiptarëve".

Këngëtari virtuoz Arif Vladi përshëndeti Presidentin e Republikës me këngën "Hajredin Pasha po vjen Radikës". Në fund, kryetari i bashkisë, zoti Ilir Krosi, i dha titullin e lartë Presidentit të Republikës "Nderi i Odës Dibrane" me motivacionin: "Mikut të madh, që me praninë e Tij i dha dinjitet e madhështi "Odës Dibrane".

Në 3 nëntor, në orën 11 të paradites, u bë parakalimi i grupeve pjesëmarrëse në shtëtitoren e qytetit. Kjo është bërë traditë tashmë në të gjitha edicionet e Odës Dibrane. Kjo paradë bëhet thjesht për të demonstruar grupet kostumet e tyre që paraqiten në festival. Larmia e ngjyrave të kostumeve të secilit grup pjesmarrës binte në sy nga larg. Grupi folklorik autokton "Rugova" dallonte nga të gjitha grupet, por dhe Presheva, Krraba e Tiranës apo kostumi i veçantë i solistes së Mirditës, i cili na kujtonte veshjen e hershme ilire.

Jo vetëm kostumet e bukura, por dhe demonstrimi i veglave muzikore bënë që qyteti i Peshkopisë të kthehej për dy net me radhë në një vend demonstrimi të vlerave kombëtare folklorike të vendit tonë. Oda Dibrane tashmë ka fituar statutin e përvitshëm, ku të gjitha trevat shqiptare konkurojnë në këtë skenë të vogël me këngë, valle, humor, kostumografi e vegla muzikore. Kavalli i Gostivarit apo lahuta e ansamblit "Rugova", kostumet e Lunxhërisë e Rekës së Epërme, por dhe të Mirditës, sivjet nuk shqiten kollaj nga kujtesa. Megjithatë, dhe vetë këto artistë që i kanë ruajtur me fanatizëm ndjehen skeptikë sot.

- E shikoj me dhimbje, - thotë lahutari i vetëm i ansamblit "Rugova", se lahuta po vjen drejt zhdukjes. Unë e bëj vetë lahutën, por interesi për të sa vjen e zvenitet. Në Shqipëri numërohen me gishta lahutarët si në Lezhë, Malësi të Shkodrës e Kosovë. Pas disa vitesh jam i bindur se nuk do të ketë njeri që do të demonstrojë në të tilla festivale me lahutë. Në Mal të Zi ka shkollë muzike që nxënësit mësojnë dhe veglën e lahutës, kurse tek ne po e braktisim shumë shpejt. Lahuta është e vetmja në arsenalin e veglave muzikore që i këndon bukur këngët epike. Jo vetëm lahuta, por dhe kavalli apo lauri të njëjtin fat kanë.

Ky festival i madh i folkut shqiptar është organizuar nga Bashkia e Peshkopisë, me përkujdesjen e vetë Ministrisë së Kulturës, Turizmit, Rinisë e Sporteve, duke financuar për Odën Dibrane. Kjo nuk mund të organizohej në mënyrë perfekte pa sponsorizuesit dibranë si: kompania "Aurora Grup", "Rrisku SHPK", hotelet "Korabi", "Veri", "Brazili", "Klajdi", firma e ndërtimit "AGZBA", Ambasada e Mbretërisë së Holandës, etj.

Natën e dytë u ngjitën në skenë grupet e Bulqizës, Drenica - Kosovë, Mirdita dhe Krraba e Tiranës. Secili grup më dinjitoz se tjetri, por juria e kishte të vështirë për të ndarë çmimet. Në juri ishin Isak Shehu kryetar, Zana Turku, zv. ministre e Kulturës, Kastriot Tusha, Lili Cingu, Ibrahim Roçi anëtar. Përpara se të ndaheshin çmimet, grupi i Peshkopisë dha një koncert përshëndetës, ku spektatorët i përshëndeti edhe tenori i njohur Kastriot Tusha.

Në emër të jurisë, kryetari i saj Isak Shehu ndau çmimet e edicionit të trembëdhjetë të Odës Dibrane. Me çmime u nderuan grupe, por dhe solistë e valltarë si Gostivari për këngën polifonike, Presheva për vallet e bukura të saj, Vlora për këngën e Kosovës, Shkupi për vallen e Asllan Agës, Bulqiza për këngën e Baba Fejzës, Mirdita për këngën humoristike etj. Me çmim karriere u nderua dhe koreografi dhe valltari virtuoz i Peshkopisë, Xhevat Fana. Çmimin e tretë e mori Gramshi, çmim të dytë ansambli "Rugova", çmim të parë Zhur-Kosovë dhe çmimin e festivalit e mori Qendra kulturore "Haki Stërmilli" Peshkopi. Kështu u mbyll dhe edicioni i trembëdhjetë i Odës Dibrane, ku Zana Turku - zv. ministrja e Kulturës do të shprehej: "Kjo Odë e vogël qenka shumë e madhe dhe jam e bindur se kështu si po veprohet do të vazhdojë gjatë".

Oda dibrane ka nisur jetën për herë të parë në vitin 1994, i konceptuar si një takim mbarëkombëtar, ku të pasqyrohej tradita e popullit tonë, në një gjini krejt të veçantë, atë të këngës, valles humoristike, ritit dhe alegorisë. Kjo bëri që Oda Dibrane të rritej ndër vite, duke u konsoliduar dhe krijuar një emër të padiskutueshëm në të gjithë Shqipërinë e më gjerë. Tashmë ky festival është bërë tradicional dhe mbarëkombëtar, me pjesëmarrje nga Shqipëria, Maqedonia, Kosova dhe vise të tjera të Ballkanit, ku jetojnë shqiptarët. Oda Dibrane pati një ndërprerje në vitin 1996, për arsye të mosfinancimit dhe mungesës së interesimit nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve. Festivali rinisi në vitin 1997 me gjithë trazirat e shumta që ndodhën në këtë vit. Që nga vitit 1997 e deri më tani, Oda Dibrane nuk është ndërprerë, por gjithmonë ka ardhur në rritje, duke u bërë kështu Peshkopia vendi ku demonstrohet folku më i bukur i trevave shqiptare, i kostumeve, humorit, riteve dhe alegorisë.

Atë që nuk mundet që ta organizojë vetë shteti, njëherë në katër vjet, siç është festivali folklorik i Gjirokastrës, e organizon Peshkopia në çdo vit. Kjo është një nismë e mirë që duhet përshëndetur, por dhe mbështetur fuqishëm nga dikasteret përkatëse, se vetëm kështu folklori ynë aq i pasur jeton gjatë dhe nuk vjen në zvenitje. Megjithatë, dhe ky festival ka të metat e tij teknike, pasi s'mund të jetë çdo gjë perfekte. Shprehim bindjen se në të ardhmen drejtuesit dhe organizatorët e tij do të jenë në gjendje që t'i eleminojnë këto dobësi dhe të meta në dukje, por që bien në sy qoftë për vendasit, qoftë dhe për të ardhurit.

Në Dibër të Vogël- Peshkopi më datë 2 dhe 3 nëntor u mbajt Festivali i 13 me radhë "Oda Dibrane 2007" ku morrën pjesë 14 shoqata kulturore dhe artistike nga Shqipëria,Kosova, Kosova Lindore Maqedonia dhe Mali i Zi.

Me praninë e tyre këtë festival e madhëruan Bamir Topi, president i Shqipërisë, Lulzim Basha, ministër i jashtëm i Shqipërisë, ammbasadori i Hollandës, deputetët e rrethit Sali Shehu dhe Rahim Kaleci, Argëtim Fida kryetar i Dibrës së Madhe, Nevzat Bejta, kryetar i Gostivarit, Azbi Lika, kryetar i Tetovës dhe Izet Mexhiti, kryetar i Çairit të Shkupit.

Ilir Krosi, kryetar i Bashkisë së Dibrës së Vogël-Peshkopisë, duke e shpallur Presidentin Topi "Nder i Odës Dibrane", u shpreh se:"Arti bashkon dhe vllazron zemrat, krijon ura bashkëpunimi mes trojeve shqiptare dhe popujve të rajonit. Në të ardhmen ky manifestim do të zgjerohet edhe me praninë e grupeve kulturore artistike të Ballkanit".

Bamir Topi me këtë rast deklaroi se:"Oda Dibrane" veç tjerash simbolizon mikpritjen, bujarinë dhe patriotizmin e shkëlqyer dibran ndër shekuj. Oda Dibrane është institucion ku kombinohen të gjitha trevat, shkëlqen plot dritë ku kombinohet arti që nëpërmjet kostumeve, instrumenteve , këngës e valleve burimore, bashkon edhe zemrat e shqiptarëve kudo qe jetojnë në këto momente të rëndësishme të historisë".

Gjatë dy netëve të Festivalit "Oda Dibrane 2007" me këngët, folklorin, me ritet dhe alegorinë e tyre para artdashësve, u paraqitën Qendra Kulturore nga Dibra e Vogël-Peshkopi, SHKA "Rexhep Mulliqi"- Preshevë, SHKA "Rilindja" Nerazhdë-Tetovë, SHKA Bllaca"-Bllacë-Shkup, Ansambli "Rugova"-Pejë-Kosovë, Ansambli polifonik i vallve Gërmec-Vlorë, Qendra Kulturore –Gramsh, Qendra Kulturore-Peshkopi, Ansambli Artistik i Valleve "Emin Duraku"- Zhurr"-Kosovë , SHKA "Sami Zendeli"-Negotinë-Gostivar, SHKA "Lullja e malsisë"-Strojan-Gostivar, Qendra Kulturore-Mirditë, Qendra Kulturore Bulqizë, Ansambli "Visaret e Krabës"-Tiranë dhe Ansambli i Ulqinit"-Ulqin.

Juria e përbërë nga Suzana Turku-zv/ministre e kulturës, Lili Çingu, valltare e Ansamblit të këngëve dhe valleve popullore, Kastriot Tusha, këngëtar e pedagog pranë Akademisë së Arteve, Isak Shehu, zv/rektor i Akademisë së arteve, dhe Ibrahim Roqi, valltar, shpalli grupet dhe individët më të mirë. Sipas vendimit të jurisë vendin tretë e zuri Qendra Kulturore- Gramsh, vendin e dytë Amambli Folklorik "Rugova" dhe çmimin e parë Grupi i këngëve e valleve "Emin Duraku"-Zhur- Kosovë, , ndërsa Flamurin e festivalit e mori Qendra Kulturore Peshkopi. Ndërkaq çmimet e karierës i morën Rizvan Sinani për Instrumentin me kavall-Gostivar, Llazam Bardhi, valltar i SHKA "Bllacë" nga Bllaca e Shkupit dhe Xhevat Fana, vallrat- Qendra Kulturore –Dibër e Vogël-Peshkopi. Pjesëmarrësve tjerë për origjinalitetin e trevave të prezentuara, për zellin e treguar në ruajtjen dhe kultivimin e folklorit shqiptar ju dorëzuan mirënjohje. Mysafirë të këtij fstivali ishin maestro i këngës popullore Arif Vladi

Në këtë festival edhe kësaj here u shpalosë veshjet e bukura karakteristike shqiptare, daullja, çiftelia, dairja, okarina, fyelli, gajdeja, kushtrimi dhe humori, i dhanë vulën këtij festivali. / ***R. TORTE***

DIBËR E MADHE - U promovua libri "Rruga e Arbërit" nga Dr. Faruk Kaba

Rruga jetike për dibranët dhe rajonin

Ideja për Rrugën e Arbërit e inicuar nga Shoqata e Intelektualëve "Nisma dibrane" nga Dibra e Vogël - Peshkopi dhe e mbështetur fuqishëm nga Shoqata "Bashkësia Dibrane" në Tiranë dhe nga "Votra Dibrane" - Dibër e Madhe, bëri që studimi i fisibilitetit i kësaj rruge të promovohet në Dibër të Madhe dhe ndihmoi që Dr. Faruk Kaba t'i bindë ministrat përkatës se ka ardhur koha që Dibra të lidhet me kryeqendrën shqiptare, me detin dhe me botën.



Argëtim Fida duke e dekoruar Dr. Faruk Kabën

Me organizim të pushtetit vendor dhe të Shoqatës Qytetare «Votra Dibrane», të shtunën në Dibër të Madhe u promovua libri «Rruga e Arbërit» nga dibrano-tiranasi Dr. Faruk Kaba.

Argëtim Fida, kryetar i Komunës së Dibrës së Madhe, me këtë rast deklaroi se: Rruga e Arbërit është identifikim i qenies, i shpirtit dhe i vazhdimësisë së ekzistencës së kësaj krahine, të cilës tashmë një periudhë të gjatë historike i cënohet identiteti i saj etnik. Vendosja e kufirit më shumë se gjysëm shekulli pati rol diskiminues, terrorizues të gjithë fshatrave përreth kufirit dhe intelektualëve brenda në qytet, që shkatoi migrimin e dibranëve, që nuk ishte vetëm nga ana ekonomike, por edhe nga presioni politik, nga mospasja e perspektivës. Ky kufi sot është hapur, por ende nuk e ka rolin që duhet ta ketë.

E kujt ishte ideja?

Idea për Rrugën e Arbërit e inicuar nga Shoqata e Intelektualëve «Nisma Dibrane» nga Dibra e Vogël-Peshkopi dhe e mbështetur fuqishëm nga Shoqata "Bashkësia Dibrane» në Tiranë dhe nga «Votra Dibrane» - Dibër e Madhe, bëri që studimi i fisibilitetit të kësaj rruge të promovohet në Dibër të Madhe dhe ndihmoi që Dr. Faruk Kaba t'i bindë minsitrat përkatës, se ka ardhur koha që Dibra të lidhet me kryeqendrën shqiptare, me detin dhe me botën. Kjo rrugë lidhet edhe me Korridorin 8 dhe me trasenë e trojeve shqiptare. Shqiptarët e Shqipërisë veri-lindore kanë qenë të privuar nga infrastruktura rrugore që paraqet bazë për zhvillimin ekonomik të kësaj zone që dallohet për begatinë me resurse dhe bukuri natyrore. Ndërtimi i kësaj rruge hap perspektiva për zhvillim gjithkombëtar e rajonal Ballkanik. Realizimi i kësaj rruge që tashmë ka hyrë në prioritetet e qeverisë shqiptare do të hapë rrugën për investimet e mërgatës sonë që do të ndikojë edhe në ndërprerjen e mërgimit. Inteligjenca dibrane dhe mbarëshqiptare duhet të angazhohet që edhe qeveria maqedonase të angazhohet në ndërtimin e kësaj rruge në Republikën e Maqedonisë në drejtim të Gostivarit, Tetovës, Shkupit dhe Sofjes.

Shpëtim Cami, kryetar i SHQ «Votra Dibrane», theksoi se: "Me një angazhim tepër profesional dhe përkushtues Dr. Faruk Kaba ka bërë të pamundshmen të mundshme, realizimin e kësaj arterie ëndrrash shumëshekullore e njerëzore të këtyre anëve e më gjerë. Ne sot ndjejmë gëzim të madh, sepse kjo rrugë na e hap dritaren e shpresës, dritaren për një të ardhme më të mirë për gjeneratën tonë dhe për brezat e ardhshëm. Dibra di t'i vlerësojë dhe përgëzojë njerëzit si Dr. Faruk Kaba, që mbeten krenaria jonë së bashku me shumë dibranë tjerë nga e kaluara jonë, që me punën e tyre sakrifikuan për të mbijetuar dhe për të kontribuar për të mirën e gjeneratave që vijnë pas».

Autori

Faruk Kaba, autor i librit, u shpreh se: "Me vullnet dhe dëshirë kam bërë detyrën time, falë edhe bashkëpunëtorëve të mi. Pas një jave do të fillojnë punimet në këtë rrugë që relacionin Dibër e Madhe- Tiranë e bëjnë vetëm 75 kilometra për ta bashkuar pjesën tjetër të Shqipërisë me Dibrën e Madhe. Kjo rrugë do të jetë nga më të bukurat dhe më të rëndësishmet në Ballkan. Dibranët kudo janë të nderuar, sepse janë punëtorë, të ndershëm, të zgjuar dhe këtë zgjuarësi në jetë e përdorin ku duhet. Për Rrugën e Arbërit janë hartuar tri variante dhe varianti më i pështatshëm është varianti i dytë që fillon nga Tirana, lumi i Tiranës afër Tufinës, shkalla e Tujanit, Qafë Murriza, Ura e Vashës, Planbardhi, Qafë Bulli, Bulqiza, Ura e Qytetit, Zerqani, Ura e Çerenecit, Gjorica dhe Dibra e Madhe".

Mr. Ruzhdi Lata, myftiu i Dibrës, duke folur për autorin dhe veprën e tij, shtoi se: "Për një vepër duhet pasur ide. Në fillim të librit, autori shkruan, "homazh për prindërit e mi, që me urtësi e përkushtim brumosën tek unë dashurinë për atdheun dhe Dibrën time". Titulli i i Dr. Faruk Kaba, doktor i shkencave, pedagog në Fakultetin e Inxhinerisë së Ndërtimit në Universitetin e Tiranës, themelues i Kompanisë konsulente «Infratransproject Ltd », drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, President i Shoqatës Shqiptare të Inxhinierëve Konsulentë, anëtare e FIDIC, anëtar i Këshillit Kombëtar të Rrugëve, anëtar i Akademisë së Shkencave të Nju Jorkut, anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Kongresit të Rrugëve PIARC, projekturs i më shumë se 2000 kilokmetra rrugë e autostrada në Shqipri, ideator i aksit Veri-Jug, Korridorit Durrës-Morinë, i "Rrugës së Arbërit", tregon begraundin e një personi absolutisht të përgatitur, që për vizionin e tij të vënë në letër të na bindë se mund të realizohet. Ky libër, duke përshkrur çdo pjesë të trasesë, përmban edhe të dhëna të nevojshme historike, gjeologjike".

Shehat Marku, gjykatës, duke përshëndetur të pranishmit, tha se: "Këto takime kanë vlerë për tërë kombin për t'u vetëdijësuar se mje kësi projektesh i dalim zot vetes. Ofensivat serbe shpërngulën dibranët që u bënë populli i parë i Tiranës. Dibranët në Tiranë kanë dëshmuar vlerat e tyre edhe nëpërmjet 150 doktorëve të shkencave të lëmive të ndryshme që janë me origjinë dibrane dhe që pasqyrojnë inteligjencën, studimin, progresin dhe urtësinë e veçantë në jetën dhe shoqërinë shqiptare. SH.Q. "Votra Dibrane" me takimin promovues të studimit të fisibilitetit të "Rrugës së Arbërit", të organizuar në vitin 2003 në Dibër, ishte mbështetje e fuqishme në sensibilizimin e ndërtimi të kësaj rruge jetike për Dibrën e më gjerë".

Gjatë këtij promovimi, Argëtim Fida, në emër të pushtetit vendor e dekoroi dr. Faruk Kabën me "Mirënjohje", me motivacionin "Për merita të posaçme në projektimin, studimin e fisibilitetit dhe për projektin teknik të Rrugës së Arbërit".

Rexhep TORTE

Fjala e hartuesit

Nga **ELVANA ZAIMI**

Shënime për librin me poezi të zgjedhura të Agron Tufës "Fryma mbi ujëra"





Ja disa nga arsyet që më shtynë të bëja një përzgjedhje nga krijimtaria poetike e deritashme e Agron Tufës. Arsyeja e parë dhe shtysa themelore ka qenë dëshira për të bashkëndarë me lexuesin krijimet më përfaqësuese nga poetika e këtij autori.

Të bashkëndash mahninë estetike të leximit me të tjerë, mendoj se është virtyti më bujar që ka poezia e mirë, e cila, edhe pse mbetet atribut i leximit elitar, prapë se prapë nuk i shmanget funksionit shoqëror të komunikimit. Sepse poezitë e këtij vëllimi, në dialogun e pandërprerë me lexuesin, i binden një urdhri të brendshëm, që ta imponon vetvetiu poezia: "Bëhu si unë!". Një arsye tjetër që më shtyu drejt kësaj përzgjedhjeje, është fakti se poezia e këtij autori, megjithë prestigjin që gëzon, është thuajse e panjohur, për shkak se të tre librat e tij poetikë, "Aty te portat Skee" (1996), "Rrethinat e Atlantidës" (2002), "Avangardë engjëjsh" (2005), nuk kanë arritur deri te lexuesi, si pasojë e mangësive të rënda që paraqesin instancat botuese dhe tregu ynë i deformuar.

Arsyeja e tretë është qëndrimi indiferent i autorit ndaj kulturës së promovimeve dhe sindromës epidemike të mediatizimit.

Pas kësaj hyrjeje të shkurtër, e kam më të thjeshtë t'ju bëj me dije qëllimin e kësaj përzgjedhjeje: risjellja e freskët e bërthamës poetike të poetit, i cili jeton në një kontekst të pandërprerë të krijimtarisë së vet prej thuajse dy dhjetëvjeçarësh.

Nuk kam aspak ndërmend të marr përsipër kategorizimin dhe interpretimin letrar të poezisë së Tufës, as kritikat e ndryshme të receptimit, pasi më pëlqen ta shoh këtë botim të zhveshur nga të gjitha barrat e panevojshme të përkufizimeve, për faktin mod-est se nuk jam pozicionuar asnjëherë si interpretuese e poezisë, duke mbajtur të pacënuar vetëm marrëdhëniet personale të përjetimit. Prandaj dhe kjo përmbledhje është mënyra se si e lexoj unë poezinë e Agronit, sepse është një zgjedhje, natyrisht, krejt subjektive, subjektivitet që është po kaq natyrshëm, i pashmangshëm.

Në poetikën e Tufës kam dalluar dominimin paralel të këtyre linjave të poezisë: të vargut të lirë, me rima spontane, të metrikës klasike deri në format më të rrepta, si katrena, distiku, hekzametri dhe soneti, deri te *vers libre* dhe prozat poetike. Ideja dhe dëshira ime ishte të krijoja jo një libër kronologjik, por një strukturë organike, ku të bënin pjesë të gjithë elementët autentikë të poezisë së Agron Tufës. Me larminë e tyre, të gjitha këto forma të sipërpërmendura e vështirësojnë mjaft arkitekturën ciklike të librit, pasi kjo larmi prozodike paraqet në tërësinë e saj një poetikë sa origjinale, aq dhe eklektike. Megjithatë, kriteret orientuese nga të cilat jam udhëhequr, kanë qenë klasifikimi sipas grupimeve tematike, sipas zhanrit dhe të karakterit eksperimental. Kësisoj, janë përvijuar disa linja, që përfshijnë lirikën meditative, lirikën e peisazhit psikologjik, lirikën intime, përvojat eksperimentale, lirikën elegjiake, baladat, prozat poetike dhe llojin e veçantë të poemës së shkurtër, që përcaktohet nga ndeshja intensive e ideve metafizike.

Sipas meje, ky ishte një rikuptimësim i rrugëtimit poetik të deritashëm të autorit, duke qenë e ndërgjegjshme për mënyrën krejt personale të përvijimit të këtij sistemi, pa marrë përsipër të bëj ndonjë profeci për këtë poetikë të hapur...

Besoj se lexuesi i rafinuar i poezisë nuk ka nevojë as për këshilla e as për tabela orientuese që ta çojnë në ndonjë pikëmbërritje të caktuar. Çdo akt leximi është, në njëfarë mënyre, pjesëmarrje në krijim, ndaj dhe çdokush që mund ta lexojë këtë libër, mund ta ndjejë veten si në vargun e John Ashbery-t:

...and the poem
Has set me softly down beside you. The poem is you[1]

[1] Dhe poezia butësisht më solli pranë teje. Poezia je ti (Nga "Paradokse dhe oksimorone")

Copëza kujtimesh me profesorin dibran të gjeologjisë

Pjesë nga libri i pabotuar i autorit "SHËNIME NË ÇADËR"

Nga VESEL HOXHA*

Në vend të hyrjes…

Sot fshati Zogjaj, ku lindi e u rrit profesori dibran i gjeologjisë Ing. Bashkim Lleshi, është i përfshirë në ndarjen administrative të rrethit të Bulqizës, në komunën e Shupenzës, megjithatë, ne e kemi quajtur profesorin dibran – pasi dhe fshati në fjalë i saj është, pavarësisht nga ndarjet e sotme administrative, që ndryshojnë jo rrallë e nuk kanë jetëgjatësi…

Ishte 16 gushti i vitit 1974. Sapo kisha marrë emërimin në Komitetin e Partisë të rrethit Dibër, për të punuar në Ndërmarrjen Gjeologjike të Bulqizës, nga shefi i kuadrit i asaj kohe zotni Ramiz Leka, ku për hir të së vërtetës, më priti me dashuri e respekt, por le t'i lëmë për një shkrim tjetër këto detaje me mbresa e kujtime. Paraqitem në Drejtorinë e Ndërmarrjes, ku më priti drejtori i saj zotni Ismail Losha, që më vonë do të bëhej ndër miqtë e mi të çmuar, që unë do të vlerësoja gjatë punës e jetës time në këtë sektor të vështirë të ekonomisë që, për fat të keq, nuk e ka sot atë vlerësim që do të dëshiroja të kishte sektori i gjeologjisë, një forcë e drejtpërdrejtë prodhuese me rëndësi ekonomike e strategjike, duke u trajtuar dhe zhvilluar si një shkencë konkrete me rëndësi të madhe praktike e teorike, që lidhet me lëndët e para minerale, me përdorimin e tyre në jetën e përditshme për ngritjen e uzinave, fabrikave, reparteve, kombinateve e përpunimit të tyre.

Me këmbë të mbarë…

Pasi shkëmbyem përshëndetjet e rastit dhe bëra vetëprezantimin, duke shpjeguar arsyen pse ndodhesha aty, drejtori më dha të kuptoj se duhej pritur kryegjeologu për të parë mundësitë e emërimit, duke e kombinuar këtë të fundit me temën time të diplomës që më ishte caktuar nga fakulteti, pasi në atë kohë, pas mbarimit te studimeve të larta, duhej bërë një vit stazh, ku do të punohej për mbrojtjen e saj. Ndërsa drejtori po mendohej, si i ri që isha, nuk ndenja pa folur, duke u munduar të kuptoj tërthorazi se ku do të ishte afërsisht vendi im i parë i punës. Me qetësinë që e karakterizonte dhe me të foluren e tij karakteristike e të ngadaltë, më shpjegoi se sot pasdite do të mblidhemi dhe do të vendosim. Si për habinë time bie një zile e fortë telefoni, dhe, meqë isha edhe afër tij dëgjova pothuaj tërë bisedën që zhvillohej… Jam Bashkimi, shoku drejtor… flas nga Dhoksi… në sondën e Rakip Karajt (të më falin nëse nuk jam i saktë në emrin e brigadierit të sondës Zif - 650)... në profilin LXXXV... kemi një rezultat … shpimi nr. 1092 ka takuar krom të pasur... në thellësinë nga 642.5 m deri në 645 m… na vërtetohen mendimet për strukturën… na zhvillohet mirë perëndimori i katërt dhe… na hapet një perspektivë e madhe dhe, ndoshta është shpejt të themi, por rezultati flet se Bulqiza me Batrën duhet të jenë pjesë e të njëjtit vendburim etj. Këtë zë burrërror nuk e dëgjoja për herë të parë dhe nuk ishte vështirë të konstatoje gëzimin me të cilin fliste e raportonte. Pasi e dëgjoi deri në fund, drejtori, me një mirësjellje të habitshme, më kërkoi të thërrisja inxhinierin e vjetër e të talentuar të vendburimit të Bulqizës, të ndjerin Koço Gushi, ndërkohë vazhdonte komunikimin me të në telefon. Kuptohet, ai e thirri inxhinier Koçon që të kuptonte detajet dhe rëndësinë e rezultatit, pasi drejtori nuk ishte specialist gjeolog. Do të vijmë në Dhoks dhe do ta festojmë rezultatin… - tha drejtori, ndërsa matanë telefonit u dëgjua thënia bujare mirëse të vini dhe me këmbë të mbarë… Rezultati i marrë në këtë profil në kufi me profilet e vendburimit të Batrës, ishte me të vërtetë një rezultat me një rëndësi të madhe, rëndësinë e të cilit do ta kuptoja më vonë, pasi gjatë punës do të mësoja për të "fshehtat" e



këtij vendburimi të madh me famë botërore. Në raste të tilla, gjërat rrjedhin me shpejtësi dhe nocioni i orarit zyrtar e humbet kuptimin, ndonëse më vonë gjatë punës nëpër ekipe gjeologjike do të mësohesha se në gjeologji e sidomos në ekipe të largëta malore, vetëm orari i gjumit të ndan nga puna kërkimore dhe hallet e punëtorëve, ndonëse kjo nuk ishte e kuptueshme edhe në atë kohë nga disa drejtues burokratë, brenda dhe jashtë ndërmarrjes, në komitetin e partisë e deri në ministri.

Pas njëfare kohe u mblodhën shumë punonjës në ambientet e ndërmarrjes. Ishte bërë rregull që në këtë orar të mblidheshin drejtuesit kryesorë të ndërmarrjes për të bërë atë të famshmin takim të ores 16^{00} ose siç thuhej ndryshe takimi "5 minutësh", ndonëse shumicën e rasteve i kalonte 30 minutat. Qëllimi kryesor i këtij takimi, siç do të mësoja dhe do të mësohesha më vonë edhe unë, ishte njohja me problemet e dala gjatë punës në turnin e parë dhe marrja e masave për turnin e dytë e të tretë, që ecuria e planit të punimeve gjeologjike të kishte ecurine normale jo vetëm në turnin e parë.

Mesa duket, pasi kishin diskutuar rreth emërimit tim, siç veprohej rëndom edhe në raste të tjera, më thirrën në zyrën e drejtorit, i cili më komunikoi shkurt: Menduam të punoni në Ekspeditën Gjeologjike të Dhoksit, të punoni me Ing. Bashkim Lleshin, njërin nga specialistët tanë më të mirë, i cili do të jetë edhe udhëheqësi juaj i diplomës. Ju, mesa duket, keni ardhur me këmbë të mbarë - vazhdoi drejtori me buzën në gaz - pasi sot, ato (Ekspedita Gjeologjike e Dhoksit), siç mund ta keni kuptuar edhe nga biseda ime telefonike në mesditë, kanë marrë një rezultat të rëndësishëm, i cili na ka gëzuar të gjithëve. Atje drejton punimet inxhinier Bashkim Lleshi - besoj ke dëgjuar për të – dhe vazhdoi, duke thënë se rezultati i përket projektit të hartuar prej tij. Sigurisht, unë e ndoqa me vëmendje, interes e kuriozitet të madh atë bisedë për rezultatin e mineralit të kromit, (për mineralet e tjerë të nëntokës tonë për të cilët ishim shkolluar dhe do të punonim një jetë të tërë), pasi kishte lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e diplomës, që do të më udhëhiqte inxhinier Bashkimi, i cili do të bëhej më vonë një bashkëpunëtor i ngushtë dhe një mbështetje e madhe për mua, gjer në ditët e sotme që po shkruaj këto rreshta, duke mbetur në mendjen time njeri i punës e i mendjes, ku dhe sot e kesaj dite, edhe pse sapo i ka kaluar të gjashtëdhjetat, vazhdon të punojë me po atë vullnet e pasion, si në vitet e rinisë kur filloi punë për herë të parë në malet e Lurës kreshnike, (në Lurën bujare, në Lurën me nëntokën e pasur, në Lurën turistike, në Lurën me pyje e kullota e, me sa e sa pasuri të tjera, ku professor Lleshi i Zogjajve të Dibrës, ka një kontribut të çmuar e të pazëvendësueshëm në aspektin e studimit dhe vlerësimit të mineralmbajtjes, veçanërisht për mineralin e Kromit, pasi për këto anë ai mbroj-

ti dhe gradën e parë shkencore gjatë karrierës së tij profesionale) po me atë korrektësi, sistematike e ndershmëri që e ka karakterizuar gjithmonë këtë personalitet të gjeologjisë shqiptare, këtë njeri punëshumë e fjalëpak. Por le të kthehemi në fillin e bisedës me drejtorin e ndërmarrjes të asaj kohe. Po, - iu përgjigja drejtorit - jam djalë hoxhe, domosdo që dhe këmbën e mbarë do ta kem - duke shkaktuar një humor të rastit dhe të nevojshëm, pas asaj dite pune dhe të gëzueshme. Takimi im i parë me drejtuesin e diplomës dhe personazhin e shkrimit tim ishte me "rezultat", ishte me të vërtetë me "këmbë të mbarë", siç e tha shkurt e me humor Heroi i Punës Socialiste dhe njëkohësisht drejtori i Ndërmarrjes Gjeologjike të Bulqizës, ndërmarrjes më të madhe në vend të asaj kohe, zotni Ismail Losha.

Në malin e Sorokolit…

Në gushtin e vitit 1978 punonim për kërkimin e mineralit të hekurit pa nikel, siç e thërrisnin pushtetarët e asaj kohe, ose e thënë shkencërisht për mineralizimet oksido-silikate të hekurit në malësinë e malit të Sorokolit e në tërësi në gjithë zonën tektonike të Korabit, në formimet e vjetra paleozoike, siç i thërrasim ne gjeologët (në konceptin gjeologjik nocioni zonë tektonike e Korabit rrok një hapësirë gjeografike të madhe në rrethin e Dibrës, të Kukësit e më gjerë). Direktiva e kohës e kërkonte këtë mineral të rëndësishëm për ekonominë, që aso kohe importohej nga Maroku, në qoftë se nuk gabohem, për faktin e thjeshtë se akoma nuk ishte ndërtuar uzina C-12, si nyje kyçe e Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit, e cila do të ndante përmes një proçesi teknologjik të komplikuar hekurin, nikelin dhe kobaltin. Shkurt, minerali i hekurit pa element të dëmshëm për cilësinë e produktit në fjalë, kërkohej për të prodhuar çelikun e kërkuar në atë kohë nga ekonomia, që të mos importohej, që të mos harxhohej valute për ta blerë atë në vende të tjera të pasura me mineral të tillë hekuri. … Bazen e kishim të vendosur në pyllin e Kijavecit të fshatit Ploshtan, një kodër piktoreske me mështeknat e famshëm, mbi shkollën 8 vjeçare të fshatit në fjalë. Fare pranë nesh ishin vendosur ose siç ka filluar të përdoret rëndom, akomoduar, edhe specialistët e Institutit të Kërkimeve e Studimeve Gjeologjike të Tiranës, në disa çadra të bukura italiane me ngjyrë ulliri, disa metra larg lapidarit të Heroit të Popullit Hajdar Dushi. Krahas punës për ndjekjen e punimeve të kërkimzbulimit për mineralin në fjalë, ne gjeologët e Peshkopisë kishim detyrë që periudhën e verës te kryenim edhe punime gjeologo - rilevuese komplekse në shkallë 1 : 25 000, për të sqaruar perspektivën e këtij minerali në një rajon më të gjerë, në bashkepunim dhe në përbërje të grupit udhëheqës të Institutit, që në atë kohë kishte për drejtor, ish udhëheqesëin tim të diplomës, Ing. Bashkim Lleshin. Për koinçidencën e tregimit, në afërsi të majës së Sorokolit, në fillim të gushtit, kishim takuar disa copëra premtuese të mineralit oksido – silikat të hekurit, për të cilat kishim marrë kampionaturën e nevojshme për të bërë të gjitha llojet e vlerësimeve, bazuar në analizimin tyre, sa më parë të ishte e mundur. Ato ditë erdhi për të na parë në terren drejtori i Institutit. Sapo kishte filluar të binte nata dhe, papritmas, u dëgjua një zë. - Po vjen drejtori ynë, ishte zëri i specialistit Nikollë Meshi, njërit nga anëtarët e grupit studimor të Institutit, i cili nuk jeton më, por rron në kujtimet e të gjithë atyre që e kanë njohur dhe kanë punuar me të maleve të Shqipërisë, në Alpe, Korab e kudo, duke e thirrur me nofkën Leci. Njoh makinën e Xan Vrapit (Ramazan Vrapit - shoferi i drejtorit - një shofer i talentuar dhe i moshuar, por që, për nga vullneti për punë mund të themi pa frikë se ishte i paparë) – tha Leci. Në raste të tilla, kur vjen miku, qoftë ky një njeri çfarëdo apo eprori, lëvizet nga vendi – siç thuhet në gjuhën popullore. Qe e pamundur. Do të hamë darkë me ato çfarë na ndodhen. Si merakli i gramatikës që jam (kjo, jo për meritë timen, por të mësuesit ose më saktë të profesorit të gjuhës shqipe që kam pasur në tre vitet e shkollës 7 vjeçare në Fushë Alie, studiuesit të talentuar e shkrimtarit të mirënjohur Xhafer Martini), më bëri përshtypje thënia në shumës, me këto që kemi, duke futur veten dhe shoferin e tij, ndonëse e kishte bezdi këtë emërtesë dhe shpesh thoshte shoferi i Institutit, jo i imi.

Të më falë lexuesi që po zgjatem në këtë episod, por do ta shpie gjer në fund. Pas një pushimi dhe pasi i mbaruam përshëndetjet e rastit, drejtori dhe shofer Xani, të ndihmuar nga Leci, fillojnë përgatitjet për të gatuar diçka. Unë po i ndiqja me vëmendje, si i ri që isha, më bënte përshtypje gjithçka, pasi edhe ne e kishim një guzhinë verore, në qoftë se mund ta quanim të tillë. Të them të drejtën une e njihja mirë ose mendoja se e njihja mirë inxhinier Bashkimin, gjatë vitit që punuam në Dhoks, dhe më pak se viti në Bulqizë, por jo. Jo më kot thotë populli ynë se, që ta njohësh njeriun duhet të hash një thes krypë me të, pra, unë konstatova se nuk e kisha mbaruar akoma thesin. Që të mos zgjatem, Xani e kishte "guzhinën me vete" në makinë, në kuptimin e plotë të fjalës. Ai ishte në gjendje që dhe pa ndihmën e drejtorit (shpesh thoshte, unë harroj se e kam drejtor - kjo kishte domethënien e vet) të gatuante ku ta zinte nata e ku ta donte puna, (por asnjëherë nuk harronte të thoshte që drejtori është iniciatori i kësaj pune), bile të të qeraste dhe me raki. Raki - siç thoshte Xani - ball kazani, ndonëse unë për hir të së vërtetesë as nuk e njoh, as nuk e pi rakinë, kjo ndoshta një përjashtim për profesionin që kam. Kështu hëngrëm darkë dhe nuk e kuptuam nëse e pritëm ne drejtorin, apo ai na priti ne. I tillë është Bashkim Lleshi, si në majë të malit dhe në zyren e bukur e komode, i jep një kafe, të jep dy…, jo siç ndodh shpesh me drejtues të tjerë që e kanë të vështirë ta fusin dorën në xhep, kur i thonë fjalës, pale më në të tilla raste, as që mund të bëhet fjalë. Gjatë darkës pati diskutime të shumta rreth punimeve të kryera, rezultateve të arritura dhe bashkëpunimit mes grupeve të institutit, gjeofizikës dhe gjeologjisë së Peshkopisë. Në atë kohë "minerali i hekurit pa nikel" ishte në axhendën ditore të qeverisë dhe të partisë, bile partia duhej përmendur e para se kishe probleme. Bëmë si bëmë atë natë, u rregulluam për të fjetur, ndonëse bisedat rreth punëve nuk patën të sosur, kjo dhe për faktin se komentet rreth copërave të gjetura kërkonin të orientonim marshutat drejt origjinës së tyre, pra, drejt trupit rrënjësor, siç e përdorim rëndom këtë term ne, gjeologët. Nuk do të vazhdoj rrugën për në Kukës - na tha papritur inxhinier Bashkimi, drejtori, do ta ndryshoj planin, do të vij me ju në marshutë, ato copëra që kini takuar ju janë shumë domethënëse,

duhen ndjekur e verifikuar në detaje dhe unë jam tepër kurjoz ta bëj një marshutë me ju e të shohim ç`bëhet me ato copëra minerali, se për mineral paguhemi – Kukësin aty e kam, nuk ikën – e mbylli fjalën ai. Ashtu ndodhi. Në orën e caktuar grupi i rilevimit u nis për punë. Kështu e ka gjeologjia, drejtuesi duhet të punojë në terren, ndryshe harron profesionin, largohet nga njerëzit e punës, largohet nga realiteti, burokratizohet e nuk e vlerëson punën e terrenit dhe "nga karrigia e zyrës i duken malet e sheshtë dhe jo me shumë të përpjeta", bile ndodh që bëhen pengesë duke rënë viktimë e financierëve në emër gjoja të rregullit e të ligjit në dhënien e disa pagesave e shpërblimeve të punës së tyre të vështirë e fisnike. Të më falë lexuesi, por do të përmend një thënie popullore të një gjeologu sarandiot që ka punuar në Selishtë e që këto raste i ka perifrazuar në mënyrë humoristike: "Punon ariu në majë të malit dhe hanë mizat në b… të kalit"…

Rreth orës 12^{00} i ishim afruar 200 m majës së Sorokolit ose e thënë ndryshe, lartesisë 2204 m. Drejtori i Institutit – inxhinier Bashkimi – i cili vazhdonte marshutën së bashku me një specialist të Institutit, 250 m larg në krahun e djathtë të marshutes ku vazhdoja unë me një specialist të gjeologjisë së Peshkopisë, të ndjerin Ali Bardhi (u nda nga jeta në kulmin e jetës dhe që sebep ishte bërë inxhinier Bashkimi për ta sjellë në Ekipin e Korabit me kërkesën time, kjo edhe për faktin se Aliu, plus që ishte nga e njëjta zonë nga isha unë, kishte një përvojë të madhe pune dhe shquhej në kërkimet e rilevimet gjeologjike), na bëjnë me shenjë që ta ndërpresim marshutën dhe të shkojme pranë tyre. Kishin hasur në disa copëra minerali të mëdha dhe të parrumbullakosura, që flisnin se trupi rrënjësor do te ishte afër…fare afër. Deshën të siguroheshin e të diskutonim bashkërisht me ne, me mendimin se kishim fituar një fare eksperience për këto lloje mineralesh silikate dhe okside të hekurit. Po, - u themi, - janë copëra minerali nga ato që kërkojmë. Në mendje bluaja se çfarë t'u thoja për këtë sihariq që do të na ndihmonte për ta kufizuar shumë vendin se ku do të ishte trupi rrënjësor që punimet të mos venin kot, që kanalet, puset dhe më vonë shpimet të mos ishin negative. Desha të them diçka – vazhdova fjalën, duke ju drejtuar inxhinier Bashkimit dhe specialistëve të tjerë – pa lëvizur nga vendi ku isha ulur sipër një guri pak të sheshtë, një blloku të rrëzuar kuarciti. Për rastësi, para katër vitesh kur fillova punë për herë të parë në Ekspeditën Gjeologjike të Dhoksit, një sonde, episodi që e trajtova në fillim të këtyre kujtimeve, kapi mineral kromi dhe m'u drejtuan mua duke më thënë drejtuesit e asaj kohe, ke ardhur me këmbë të mbarë, tani rasti e solli që unë t'i them drejtorit të institutit që kësaj radhe ju erdhët me këmbë të mbarë tek ne… Të lumte goja! - u hodh e tha Leci, por – vazhdoi ai - na mungon Xani me makinën kineze BJ, me ballin e kazanit dhe s'kemi si ta festojmë… pasi Lecit i pëlqente ta hidhte ndonjë gotë, por vetem me shokët. (Te gjithë qeshën)…

Blloku i dokumentimit …

Ekspedita Gjeologjike e Peshkopisë ndër vite ka qenë e varur nga Ndërmarrja Gjeologjike e Bulqizës, ku për hir të së vërtetës unë personalisht, kam qenë kundër kësaj forme organizimi, ç'ka dëshmohet me letrat e shumta e të vazhdueshme që kam dërguar lart në kohën e monizmit, për t'u ndarë nga Bulqiza. Kjo kërkesë që kam përsëritur shumë vite radhazi (vitet e fundit edhe me mbështetjen e zotni Bujar Pates – në atë kohë Sekretar i KP të rrethit, i ardhur nga Bulqiza), nuk lidhej me faktin se nuk donim të punonin me njerezëit që drejtonin në Bulqizë, por me faktin se kjo varësi ka penguar në një mënyrë ose në një tjetër, me ose pa dashje… intensifikimin e punimeve dhe studimeve të specializuara e komplekse gjeologjike në këtë rreth, duke u përqendruar puna në Bulqizë, më saktë rrotull qytetit, pra, jo në rrethin e Dibrës, jo në Lurën e largët …etj. Nga mbështetësit kryesorë të kësaj ndarjeje ka qenë dhe Profesor Bashkim Lleshi,



si në kohën që punonte në Bulqizë, ashtu dhe kur erdhi me punë në Peshkopi, mbështetje që Ekspeditës Gjeologjike të Peshkopisë nuk do t'i mungonte asnjëherë, ndonëse kjo ndarje u realizua në një situatë krejt tjetër, shumë vonë, kur gjërat kishin rrjedhur e ndryshuar, si i thonë fjalës si koshi pas të vjelave dhe qe një fitore si e Pirros. Nga detyra e kryegjeologut në Bulqizë, po qe se nuk gaboj, inxhinier Bashkimi transferohet në detyrën e shefit të Industrisë të rrethit të Dibrës, më pranë nesh dhe halleve tona, ku për aq sa qëndroi në atë detyrë afatshkurtër, nuk reshti së interesuari për të na ndihmuar në mbarëvajtjen e punëve në Ekspeditën tonë. Por le ta lidh tregimin e mësipërm me atë që dua të tregoj, me titullin e vogël - Blloku i Dokumentimit…

Shpesh na rastiste që, kur kthesheshim nga ekipet gjeologjike të largëta malore në orët e vona të natës, (duke udhëtuar me orë të tëra në këmbë, pasi për makinë as që bëhej fjalë, kjo as aty ku kishte rrugë makine, pale më në zona të thella ku ajo mungonte), disa materiale të punës, për shpejtësi, t'i vendosnim mbi tavolinat e zyrave që kishim në Peshkopi, pa i siguruar në kasaforta metalike, siç ishte porosia për të ruajtur "sekretin" dhe të nesërmen t'i sistemonim e t'i vendosnim në vendin e duhur, ndonëse ambientet e tyre ruheshin rregullisht. Në një nga rastet e mësipërme më ka qëlluar që, pas kthimit nga puna prej ekipeve gjeologjike (që koha e qëndrimit zgjaste edhe me muaj larg familjes kur punonim në rilevime në shkallë 1: 25 000 apo 1 : 10 000), përpara se të paraqitesha në ekspeditë, të takoj inxhinier Bashkimin, para se ai të shkonte në zyrën e tij të punës në ish Komitetin Ekzekutiv të asaj kohe. E ftova për të pirë një kafe. Pranoi me kënaqësi dhe në bisedë e sipër më tha: - Bëre mirë që më takove, pasi kam dashur edhe unë të takohem me ju, por ndërkohë shtoi – më prit 5 minuta sa të vete në zyrë, të le një porosi dhe adresën se ku jam, pasi nuk kishte celular në atë kohë… Mirë, - i them unë, - po ju pres, duke i dhënë të kuptojë se shpreha një fare habie, ndërkohë mendja ime vazhdonte të punonte e të mendonte për korrektësine që e karakterizonte këtë njeri, pasi punën e rregullin ai i deshte e i kërkonte në radhë të parë tek vetja, pastaj tek të tjerët. Nuk vonoi dhe erdhi, duke me lëshuar dorën mbi shpatulla, siç e ka zakon, me atë ngrohtësine që e karakterizon edhe sot e kësaj dite, duke më pyetur në detaje për kërkimet dhe rezultatet, ndonëse me detyrën e re nuk lidhej drejtpërsëdrejti me ne. Ndërsa vazhdonim të pinim kafenë, gjeti momentin e duhur dhe në një mënyrë krejt të natyrshme, m'u drejtua me fjalët: Para ca ditesëh më ka ardhur... (dhe bënte sikur harronte gjërat që deshte të më thoshte që unë të mos bëhesha merak)… një instruktor për t'u ankuar se ju i lini blloqet e dokumentimit mbi tavolinë – vazhdoi me qetësi, duke më kërkuar t'i përgjigjem se si qëndronte problemi, si qëndronte e vërteta. Nuk e pashë të arsyeshme t'i them askujt në Ekspeditën Tuaj, as Sekretarit të Organizatës Bazë të Partisë dhe as Kryetarit të Ekspeditës, pa e biseduar më parë me ju. Në atë kohë kisha për kryetar ing. Selim Muçën, sot kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Emrin e sekretarit për momentin nuk e sjell ndërmend, pasi kishte organizime specifike për vetë natyrën dhe shpërndarjen që kishin ekipet gjeologjike në raport me qendrën e ekspeditës në Peshkopi.

Nuk më ka ardhur asnjë instruktor në zyrën time - i them unë, dhe vazhdova disi i nervozuar e me ironi se instruktorët e komitetit të partisë vërtet kanë zyra, jo ne, paçka që ne jemi mësuar t'i quajmë zyra, ato realisht janë baraka dhe çadra. Dakord – vazhdoi bisedën shefi, duke buzëqeshur lehtë për ironinë që përdora në bisedë (kështu e thërrisnim në kohën që punoi në Komitetin Ekzekutiv) - ashtu si thoni ju është – por tek ju ka qenë një operativ i sigurimit të Degës së Punëve të Brendshme, i cili ka relatuar në Komitetin e Partisë... - Po, - i them shkurt, - kjo është e vërtetë, duke ia shpjeguar në detaje ngjarjen, si më erdhi në zyrë dhe si u largua pa më vënë në dijeni se çfarë të mete konstatoi operativi L.M. Ashtu është – vazhdoi bisedën shefi – disa gjëra nga disa kuadro nuk kuptohen drejt dhe bëhen pa takt, pa sjellje të kulturuar dhe jo ballas, pa qenë nevoja për zhurmë e bujë e pa i fshehur gjërat, duke u shoqëruar me veprime të pahijshme e duke sjellë shqetësime të panevojshme – siç mund të klasifikohet edhe rasti juaj. Me këtë problem do të merrem unë, do ta sqaroj e do ta zgjidh – ju vazhdoni punën. Megjithatë – vazhdoi shef Bashkimi, duhet të bëni kujdes që as blloqet të mos i lini të pasiguruara dhe as në zyrë të mos fusni njerëz që nuk prezantohen dhe shpjegohen përse kanë ardhur… Tani nga lartësia e viteve e kuptoj ndihmesën e shefit, ndihmesën e njeriut të mirë, profesorit Bashkim Lleshi, pasi sot këto gjëra mund të duken qesharake, por për kohën kur tregohet kjo ngjarje, punët nuk dihej si do shkonin po të mos ishte ndihma dhe amortizimi i problemit nga profesor Lleshi, jo thjesht se kishte të bënte me një gjeolog, me njerëz të maleve e të vështirësive apo dhe pse kishte dhe një njohje me mua, por një njeri si Bashkim Lleshi e bënte këtë veprim për të gjithë njëlloj, për të gjithë njerëzit e punës, pasi idealet që e kanë udhëhequr dhe e udhëheqin këtë njeri në punë dhe në jetë janë idealet e korrektesës, humanizmit e të drejtësisë, idealet e ballafaqimit e jo skutat e errëta e thashethemet e kafeneve. Profesor Bashkimi ta thotë atë që mendon drejt e në sy, ballë për ballë, jo më për një bllok dokumentimi, por me të padrejtën ai përballet me këdo, qoftë ky dhe në majat e larta të pushtetit, siç dhe i ka ndodhur kur drejtonte Institutin e Gjeologjisë dhe të Minierave…, por, njerëz të tillë shoqëria jonë ka pak ose e thënë ndryshe, po rrallohen për ditë e më shumë, pasi "… servilët po e pinë gjithë kopenë"…

Shqetësimet e profesorit…

Koha e solli që të punojë në Tiranë dhe lidhjet me professor Bashkimin t'i kemi të shpeshta, bile jo vetëm me të, por edhe me shumë shok e miq të mi të vjetër e të rinj të specialiteteve të gjeologjisë. Para pak ditësh e solli puna që të takohem e të shkëmbej me të disa mendime për punët e përditshme tonat, për riorganizimet që po bëhen në kuadrin e reformave që po ndërmerr qeveria dhe që prekin dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar. Midis të tjerave më bëri përshtypje shqetësimi dhe interesimi që tregonte për çdo fushë të veprimtarisë të këtij institucioni të rëndësishëm deri në detaje, për krijimin e Institutit të Gjoshkencave etj., për reformën në Sherbimin Gjeologjik Shqiptar pas krijimit të Institutit në fjalë e duke vijuar pastaj me disa shqetësime rreth rezultateve të studimeve të ndryshme që, kur vjen puna për t'u zbatuar nga organet e qeverisë, ato nuk merren parasysh, bile, merren vendime që bien ndesh me përfundimet e studimeve. Ka disa vite që ujërat nëntokësore në disa basene të lumenjeve kryesorë të Shqipërisë kanë filluar të monitorohen në sasi e cilësi, pa hyrë në detaje për problematikën dhe përmirësimet që kërkohen të bëhen nga viti në vit, nga baseni në basen, nga qarku në qark, nga akuiferi në akuifer etj., dhe në lumenjtë kryesorë të Shqipërisë po ndërtohet rrjeti monitorues…, kjo - vazhdoi profesori përbën një risi në veprimtarinë e Shërbimin Gjeologjik. Në jetën e përditshme, kur ndërmerren investime për të ndërtuar ujësjellësa për të furnizuar fshatra a qytete me ujë të pijshëm, shumë pak merren parasysh përfundimet e rekomandimet e studimeve tona me nivel shkencor, të realizuara nga këshilltari teknik e shkencor i shtetit. Ashtu ndodh edhe me rezultatet e monitorimeve të lumenjve tanë, në një kohë që merren vendime nga qeveria me nismën e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (për habinë e të gjithëve në ato grupe pune gjithçka ka, por vetëm gjeologë jo) dhe që bien ndesh me përfundimet e studimeve që japin rekomandime të qarta se ku dhe kur duhet të shfrytëzohen aluvionet e lumit. Nuk mund të mos bisedonim për Lurën, për vendbanimin e parë të profesorit si gjeolog, pasi gjuha vete tek dhëmbi – thotë populli. I kalon me radhë disa minerale që ka Lura, shqetësimet për mundësitë e futjes së firmave të huaja serioze, për t'i vënë ato në qarkullim ekonomik, për ta fuqizuar e gjallëruar Lurën e pasur me Krom, Bakër, Alumin, Hekur-Nikel, Mangan…minerale jo metalore…etj., Lurën bujare, të pushkës e të penës… Po ashtu, si njëri nga organizatorët e Kuvendit të Parë të Rrugës së Arbërit, si pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në studimin e fizibilitetit të kësaj rruge me rëndësi vendimtare për zhvillimin e Dibrës e më gjerë, krahas drejtuesit të këtij projekti inxhinierit të talentuar, Doktorit të Shkencave, zotni Farruk Kabës, nuk mund të rrinte pa e ngacmuar bisedën edhe në këtë temë.

- I dëgjove lajmet, - më tha. Jo i thashë – duke shprehur një farë habie se për çfarë lajmi e kishte fjalën. - E dëgjove çfarë tha Presidenti i Republikës në Dibër?

Pasi e vështrova përsëri me habi – vazhdoi duke më thënë – foli për rrugën e Arbërit, mbështeti ndërtimin e saj. Fytyra i ndriste nga gëzimi tek shqiptoi ato fjalë – dhe vazhdoi: - Rruga e Arbërit do të jetë një gjë e madhe për Dibrën këtej e matanë kufirit, për Matin e për shumë e shumë rajone të tjera. Ndërtimi i kësaj rruga e ka materialin e ndërtimit të rrugës, në "rrugë"…, i ka mineralet metalore e jo metalore "rrugës"…., e ka turizmin "rrugës"…, ndërtimi i kësaj rruge do të jetë rilindje e Dibrës. Ndoshta u zgjata pak, pasi për njerëz të tillë më shumë se fjalët, sado të merituara të jenë ato, flasin punët, flasin punimet e shumta shkencore, projektet e studimet në shërbim të ndërtimit gjeologjik dhe pasurive minerale të vendit tonë. Një fjalë e urtë angleze thotë: "Fjalët mësojnë, shembulli tërheq". Profesor Bashkim Lleshi është shembulli që tërheq. Këto shënime i kam shkëputur (me pak shkurtime dhe me ndërprerje, ku kemi vënë pikat) nga libri i pabotuar i imi "Shënime në Çadër", duke veçuar ato tregime që lidhen me profesorin e nderuar dibran, zotni Bashkim Lleshin, që një jetë të tërë ia kushtoi Gjeologjisë.

** Përgjegjës i Sektorit të Programimit dhe Vlerësimit të Projekteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Autori mban Gradën Shkencore "Doktor" në fushën e shkencave gjeologjike.*

Semiotika e dasmës shqiptare*

(në variantin e Dibrës)

Nga Agron TUFA

Dasma shqiptare, në kup timin e saj tradicional, paraqet në vetvete njëfarë tërësie të *semiozis*-it që e shpie gjithë sistemin e regullave të përdorimit të gjesteve të caktuara në një tekst të vetëm. Ndërkaq është e qartë se bëhet fjalë për gjuhën e ritualeve, të ushtruara gjatë ritit të dasmës dhe që ka domethënien e saj të lidhur pashqitshëm me kontekstin e saj. Dasma ndër shqiptarë është, thuajse ceremonia më publike dhe se, ndryshe nga të gjitha llojet e komunikimit masiv, përfshin në vetvete një numër rreptësisht të kufizuar modelesh ritualore. Këto modele ritualore zbatohen në po të njëjtën ceremoni dhe përfaqësojnë një komplet gjestesh dhe frazash monotipe. Forma e këtyre ritualeve nuk ndahet nga domethëniet e tyre, ato të gjitha janë të fiksuara dhe në rrjedhën e gjatë të shekujve praktikisht asnjëherë nuk u janë nënshtruar ndryshimeve.

I. DEMI

Tradicionalisht dasma shqiptare (në këtë punim do t'i referohemi traditës verilindore - regjionit të Dibrës) nis me gosti. Shenjë e nisjes së dasmës shërben ceremonia e flisë së demit, të cilin, si rregull, duhet ta sjellë daja i dhëndrit. Demin e stolisin me lule të ndryshme, ndërsa vetë procesi i flijimit shoqërohet me këngë ritualore. Një ceremoni e tillë përmban kuptim të dyfishtë. Nga njëra anë demi mund të kundrohet si simbol mitologjik i tokës, amësisë, lagështisë, po nga ana tjetër, e përkundërta – simbol i qiellit, mashkullsisë, zjarrit. Kësisoj flijimi i demit mund të nënkuptojë depërtimin e ndërsjelltë simbolik dhe shkrirjen përfundimtare të këtyre dy elementeve, çka dhe është në fakt kuptimi i ritualit të dasmës. Sikurse shkruan dhe Shnajderi, "derisa demi i korrespondon zonës tranzitore ndërmjet stihive të Zjarrit dhe Ujit, ai, ka gjasë, simbolizon hallkat që lidhin tokën me qiellin ". (I, 103). Në ritualet e tjera shqiptare demi i flijuar simbolizon vetpërjashtimin, askezën, dlirësinë, kastitetin dhe është i lidhur me kultin e bujqësisë. Thënë ndryshe, në kontekstin e ritit të dasmës, ai përfaqëson simbolin e forcës pllenuese. Kështu, provojmë të hulumtojmë simbolikën e flisë së dasmës shqiptare nga pikëpamja semiotike, atëherë, duke u mbështetur në terminologjinë e Çarls Senders Pirsit (III), rituali i dasmës na del *referenti*, demi i flijuar *reprezentant-i*, ndërsa gjithçka tjetër e mbushur me simbolika të shumta (të gjitha këto kuptime shtrihen në boshtin e *pragmatikës*) janë *interpretantë*. Gjithë në akord me Pirsin, interpretanti është njëfarë imazhi mental, me të cilin korelon një shenjë apo një tjetër gjatë leximit të tërësishëm të tekstit. Kësisoj mbërrihet mobiliteti i pafundmë i *semiozisit* dhe vetëriprodhueshmëria e tij – kur secili reprezentant tjetër (demi i flijuar) thuajse sërish e sërish përlind interpretantë të rinj (kuptimin simbolik të receptuar në një mënyrë a në një tjetër nga pjesëmarrësit e rituralit), dhe, në të kundërt, interpretantët e shfaqur sërish janë të aftë të japin impulsin për një gjallërim të ri të stadit interpretant të ritualit (d.m.th., zgjedhjen e një demi të ri për flijim dhe flijimin e tij si të tillë).

II. "ODA"

Procese të ngjashme shenjore ngjasin përgjatë gjithë ceremonisë së dasmës, të cilën, për demonstrim, mund ta ndajmë në disa fragmente të rëndësishme.

Pas flisë veprim ritualor tepër i rëndësishëm është pritja e të grishurve (gostarëve). Para se me hy në "odë", të gjithë dasmorët (të burrave) vendosen sipas rëndësisë, në përputhje me hierarkinë e moshës apo largësisë regjionare. Dasmorët e grishur çapitën ngadalë dhe solemnë. I zoti i dasmës – babai i dhëndrit – i përshëndosh të ftuarit më dorështrëngime dhe marrje n'grykë duke përpjekur paksa tëmthat, mandej u prin në odë. Me t'u ulur, dasmorët ngrihen në këmbë për respekt të çdo të të ftuari të ardhur dhe, duke lëvizur i bëjnë vend të ardhurit. Ndërkaq një rëndësi të madhe ka caktimi i vendeve në odë për çdo dasmor, në përputhje me moshën, aftësinë, largësinë dhe statusin e tij social. Si regull, pjesëmarrësit e kuvendimit i dinë që më parë vendet e tyre, edhe nëse i zoti i dasmës këmbëngul në thyerjen e papërfillshme të hierarkisë (për shembull, në lidhje me ardhjen e papritur të ndonjë mysafiri të nderuar); të gjithë e dinë rëndësinë e hierarkisë dhe pavarësisht rasteve të paparashikuara – pozicionet simbolike nënkuptohen edhe në rast zhvendosjeje të vogël. Po si caktohen vendet në odën shqiptare? Vendin më të nderuar e kanë ata që vendosen në të djathtë e në të majtë të oxhakut. Rëndom këto vende i zënë dasmorët më të thyer në moshë, anipse këto vende të nderuara mund t'i zërë edhe ndonjë i huaj që ia beh papritur, çka tregon një shkallë të veçantë respekti ndaj tij. Formohet kësisoj një rreth hierarkik. Në varësi nga fakti se çfarë vendi zënë të ulurit në odë, ai kuvendon sipas statusit të tij. Pikërisht kuvendimi që zhvillohet në odën shqiptare paraqet në vetvete një dukuri të rrallë enigmatike. Nocioni "oda" ka jo vetëm kuptimin e pastër të interjerit; "odë" në të kuptuarit shqiptar quajnë bisedat ceremoniale që zhvillohen ndërmjet të ftuarve të seksit mashkull gjatë dasmës dhe jo vetëm dasmës. Oda tradicionale shqiptare në variantin e Dibrës që kemi zgjedhur, të ndërmend diç të ngjashme me një spektakël teatral. Në odë janë të pranishëm si regjizorët, ashtu dhe aktorët, statistët dhe shikuesit/dëgjuesit. Gjatë kohës së këtij spektakli lind një zhanër - unikal për Ballkanin - zhanri i parabolave alegorike. Përderisa dasma është një festë gazmore dhe festive, edhe oda ligjëron me një ton më të shlirët e altruist, se sa kuvendimet e tjera ceremoniale dhe, si rezultat i kësaj lehtësie, oda prodhon një ligjërim të nginjur në alegori.**.

Kuvendimi tradicional alegorik shqiptar i ka rrënjët thellë në mesjetë, çka për së pari ka qenë fisksuar në traditën e Kanuneve vetqeverisëse, të cilët kanë funksionuar deri në mes të shekullit XX. Sot, për ndikimin e madh të Kanuneve në jetën e përditshme të shqiptarëve dëshmojnë veçse reminishenca, kryesisht në zonat tepër malore të Shqipërisë së Veriut. Si regull, fillestarët e kuvendimeve alegorike janë pleqtë dhe, të ftuarit më të rëndësishëm me shkallë të madhe influence. Dytre prej tyre, japin, si të thuash, tonin e kuvendimit për gjithë shtrirjen e temës apo problematikës, duke vendosur me parashtrimin e kuvendimit një farë "kodi" që përcakton shtjellimin, derisa në kuvendim të jenë përfshirë dhe pjesëmarrësit e tjerë, prej të cilëve, disa marrin anën e inicuesve, ndërsa të tjerët formësojnë palën opozicionuese. Që nga momenti i parë, me skicën e parë alegorike deri tek e fundit – kuvendimi shtjellohet dhe rrjedh, siç thonë shqiptarët, "nën qilim" (d.m.th., padukshëm, hermetik, i fshehur pas maskës alegorike), dhe pak nga pak në kuvendim gjenden të përfshirë të gjithë pjesëmarrësit e odës që "ia qëllojnë" ta deshifrojnë imazhin e kuvendimit jo menjëherë, duke u familjarizuar me shkallën e abstraksionit dhe semantikën e ngjeshur. Larmia e tipave dhe karaktereve të pesonazheve në parabolat alegorike stimulon interpretimin e një radhe të tërë konfliktesh të ndryshme: politike, ekonomike, shoqërore, morale, religjioze e filozofike. Këto konflikte cekin, si të thuash, temat më të mprehta, kështu dhe përplasjet janë nga më të egrat, por puna kurrë nuk shkon deri tek rrahja apo shkrepja e armëve, ndërsa "fitorja" u përket atyre që ditën ta argumentojnë mendjehollësinë e tyre me parabolat alegorike më bindëse, duke shfaqur një origjinalitet krijues në artin e kuvendimit. Zakonisht dyluftime të tilla alegorike ngjasin ndërmjet dy pjesëmarrësve themelorë të diskursit, të cilët ndajnë pikëpamjet e dy palëve në odë. Mirëpo shpesh këto duele ndërfuten artificialisht për t'i dhënë shije të mprehtë kuvendimit dhe bukuri virtuoze odës së dasmës. Në raste të tilla përballja konfliktuale ndërmjet paravolive alegorike duket, si të thuash, "jo e vërtetë", "e sajuar", sikundërse të gjitha personazhet e këtyre historive, dhe atëherë oda të ndërmend më saktë, një seancë grupore psikoterapie, sesa një ceremonial të fiksuar. Nganjëherë



"Dasëm dibrane". Pikturë nga Zaim Elezi "Zaya"

ndikim të madh gjatë kuvendimit në odë kanë jo vetëm personazhet e palëve diskursive, por edhe masa tjetër që i ndjek, e cila luan njëkohësisht, edhe rolin e spektatorit, edhe të statistëve në këtë spektakël të çuditshëm. Nga njëra anë pjesëmarrësit e dyluftimit alegorik kanë nevojë për spektatorë, nga ana tjetër, vetë kuvendimi për shtjellimin e vet kërkon herë përkrahje, herë kundërshtime, dhe atëherë spektatorët shndërrohen në pjesëmarrës (statistë). Kësodore, statistët përfaqësonin në vetvete një pjesë të mekanizmit të riprodhimit dhe shtjellimit të paravolisë alegorike, se sa të lehtësonin mobilitetin e semiozisit të odës. Nganjëherë pjesëmarrësit e dyluftimit në alegori, të frymëzuar nga roli i tyre, gjakojnë të shpotisin jo vetëm kundërshtarët e drejtëpërdrejtë, por edhe ndonjë tjetër prej spektatorëve. Atëherë njëri nga spektatorët (ose një grup i tërë) merr rolin e viktimës në spektaklin e luajtur. Rëndom dyluftimet zhvillohen në një frymë mjaft paqësore, kështuqë roli i spektatorëve mbetet jo fort i theksuar. Në këto raste pjesëmarrësit e duelit i zhvillojnë argumentat e tyre në frymë filozofike, duke u përpjekur që me ndihmën e skicave alegorike të shpjegojnë dukuri të ndryshme universale të jetës. Më ka qëlluar të marr pjesë në një odë të Shqipërisë së Veriut, në të cilën, në cilësinë e temës diskursive, u shtrua çështja: "*A ka vallë të drejtë njeriu të betohet për diçka që është edhe e vërtetë, edhe e pavërtetë*?". Njëri prej ligjëruesve të kuvendimit në odë, tha përafërsisht kështu: "*Në kohëra të vjetra, kur njerëzit besonin se beja e rrejshme jo vetëm atë që e bën, por shumë breza të tjerë pasardhësish, të cilët, herë-dokur, do t'i zërë beja rrejshëm. Njëherë dy katundarë që u grindën për një copë tokë, u detyruan të bëjnë be para pleqve. Njëri prej tyre, të cilit nuk i takonte toka, mbushi çizmet me dhe që më parë në kopshtin e vet, dhe mandej i veshi e shkoi të betohet. Ai i ra rrotull tokës që nuk i takonte dhe shpalli me zemër të lehtë para të gjithëve: - Betohem në Allahun e Madh dhe Muhamedin se dheu që kam poshtë këmbëve, është toka ime*". Dylyftimet me alegori gjithnjë përmbajnë vështirësi të brendshme që lindin jo aq sa nga natyra e zhanrit, se sa nga auditori i odës. Në odë marrëdhëniet ndërmjet njerëzve mund të jenë qysh më parë të ndera, për arsye të ndryshme, por mund të përkeqësohen dhe acarohen gjatë ligjërimit alegorik në odë. Me qëllim që të shmangen konfliktet e hapura në dasëm, rëndom përllogaritet paraprakisht përbërja e odës, personaliteti i të pranishëmve dhe natyra e konflikteve ndërmjet pjesëmarrësve. Interesin më të madh estetik e përfaqëson oda të cilën ne e shenjojmë si konvencionale apo sinjifikative. Është pikërisht ai lloj kuvendimi gjatë të cilit konflikti i shtjelluar merr karakter masimalisht abstrakt, ndërsa vetë alegoria përfaqëson në vetvete më fort një zbukurim retorik, se sa konfrontim të hapur ndërmjet dy palëve në truallin e moralit. Biseda kovencionale rrjedh e qetë, pa ndofarë sforcimi të veçantë dhe që në zanafillë merr njëfarë kodi bisedimor, të kuptueshëm për të gjithë. Si regull, me qëllim që oda të hyjë në shtratin e ligjërimit alegorik, kërkohet njëfarë shkaku special. Ky shkak ndihmon për ta shpërngulur kuvendimin në një nivel të ri ligjërimor dhe të mos përlyhet me llomotitje për hallet e përditshme rutinore. Kësisoj, ky shkak motivon të lindë një zinxhir i tërë kompozicional fragmentesh alegorike. Ja njëri shembull.

(Vijon numrin e ardhshëm)

** Ky punim i vogël është shkruar në rusisht dhe është botuar në revistën filologjike moskovite "Novoje literaturnoje obozrenie", nr 48. 2000*

***Në këtë kuptim atdheun e alegorisë tradicionale shqiptare mund të quajmë Dibrën.*

FESTA E 28 NËNTORIT- FESTA MË E MADHE KOMBËTARE

Bashkatdhetarët tanë nga Dibra e Madhe në Nju Jork e festuan 28 Nëntorin - 95 vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë



Nga ***BEQIR SINA, Nju Jork,***

BENSONHURST - BROOKLYN, NY: Sot, kur e përkujtojmë këtë datë historike, kemi arsye të gëzohemi, por edhe të mendojmë për të ardhmen tonë, theksuan udhëheqësit e Shoqatës Atdhetare Dibrane,gjatë fjalimeve të tyre në mbrëmjen festive kushtuar 95- Vjetorit 28 Nëntorit 1912 -Ditës së Flamurit , -Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Ata thanë se :"Kemi arsye të gëzohemi, sepse, pikërisht me 28 Nëntor 1912, u shpall pavarësia e Shqipërisë, lirimi i shqiptarëve nga robëria otomane. Kurse, edhe kemi arsye të mendojmë e punojmë, edhe më shumë, sepse më këtë pavarësi gjysma e trojeve shqiptare, mbeten fatkeqësisht, jashtë "trungut" të Shqipërisë mëmë. Kosova pa pavarësi, Kosova Lindore, Shqiptarët e Maqedonisë, ata të Malit të Zi, e Çamëria, ende nuk kanë ato të drejta që i meritojnë dhe u takojnë atyre.

Në një ambient të vogël por modest, të dekoruar me të gjitha ngjyrat e simboleve kombëtare, mbremë në një lagje nga më të banuarat nga shqiptarët, në Bruklin, në lokalin e njohur "Micali Terrace", ishin tubuar shumë bashkatdhetarë tanë, që ta përkujtojnë dhe festojnë 28 Nëntorin, festën tonë më të madhe kombëtare. Ishin tubuar t'a përkujtojnë këtë ditë të shënuar, 28 Nëntorin e vitit 1912, kur plaku i urtë e i mençur Ismail Qemail,i e ngriti flamurin në Vlorën heroike, duke shpallur pavarësinë e Shqipërisë dhe realizmin e ëndrrës shekullore të shqiptarëve.

Mbremja u udhëhoqë nga n/kryetari I Shoqatës Atdhetare Dibrane z Muharrem Borova. Si zakonisht, ajo u hap me këndimin e dy himnve kombëtare, të Amerikës kënduar nga Valentina Papraniku dhe himni i Shqipërisë, kënduar nga këngëtarja Irma Libohova. Mëpastaj me një minut në heshtje, është bërë nderimi i të gjithë, heronjëve e dëshmorëve, që ranë për çështjen shqiptare. Pastaj, të pranishmëve, u foli kryetari i Shoqatës Atdhetare Dibrane, zoti Ibrahim Kolari, i cili mes tjerash tha;

Së pari më lejoni që në emrin të këshillit të SHAD-s,në emrin e grupit organizativ, dhe në emrin tim personal , t'ju përshëndes dhe t'ju uroj festën e madhe - "Gëzuar Dita e Flamurit Tonë Kombëtarë, Dita e Shpalljes së Pavarësisë".

Në këtë ditë të lavdishme historike, ne sonte jemi mbledhur këtu, vazhdoj kryetari i SHAD-it, z. Ibrahim Kolari,- të përkujtojmë të gjithë ata që luftuan për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe çlirmin nga Perandoria Otomane. Në këtë nëntor ne kujtojmë po ashtu të gjithë ata që ranë në luftë për çlirimin e Kosovës dhe të gjithë ata që luftuan për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, Mal të Zi, Preshevë me rrethinë dhe Çamëri.

Mirëpo, sot ne kemi edhe një arsye tjetër të tregojmë, se përse shqiptarët, janë me fat që kanë një diasporë të fuqishme, të përkushtuar për mbrojtjen e çështjes kombëtare. Pasiqë, u shpreh Kolari, pa ndihmën e diasporës , as Shqipëria e as Kosova nuk do të ishin në këtë gjendje, ku janë sot. Ne jemi me fat që kemi aleat Amerikën tonë, që ka bërë aq shumë për kombin shqiptar, ceku në fjalën e tij Kolari..

Mirpo, gjatë fjalës së tij, ai nuk la pa permendur edhe faktin se kjo mbrëmje përputhet edhe me ditën e njohur këtu në Amerikë si "Thanksgiving" që do të thotë dita e "Faleminderimeve". Prandaj, ai ka shfrytëzuar rastin që t'ju a urojë këtë fest të madhe të Amerikës, të gjithë të tubuarve, dhe të lutemi për pavarësinë e Kosovës..

Duke u ndalur tek çështja shqiptare sot, ai tha se ne nuk duhet të jemi të kënaqur me të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, sepse, ata nuk i gëzojnë të drejtata që i meritojnë. Fatkeqësisht, "Marrëveshja e Ohrit", sipas tij ende nuk është realizuar në praktikë. Fajtore për këtë, ka thënë z Kolari, është qeveria e Maqedonisë, por edhe shqiptarët kan fajin e vet. Ata nuk po arrijnë të bashkohen rreth qëllimit të shejntë kombëtar. Kështu që, ne u bëjmë apel partive politike që shqiptarët të punojnë së bashku për të mirën e kombit tonë, pohojë ai.





Zonja e Zotërinjë, ne me këtë rast përshëndesim zgjedhjet e fundit në Kosovë, të cilat, kaluan në një mënyrë paqësore e demokratike dhe ju bëjmë apel gjithë klasës politike që në momentin e duhur të shpallin pavarësinë e Kosovës, për të realizuar ëndërrën shekullore të shqiptarëve , e për të plotësuar amanetin e gjithë dëshmorëve që ranë në luftë për lirinë e Kosovës.

Motra e vëllezër ! iu drejtua të tubuarve në fund të fjalës së tij, kryetari i SHAD-it, z. Ibrahim Kolari,- 28 Nëntori i viti 1912 i dha fund robërisë shekullore. Patriotët tanë në krye me Ismail Qemalin shpallën pavarësinë e shtetit shqiptar, por fatkeqësisht mese gjysma e tokave shqiptare mbeten jashtë kufirit. Përpjekjet për bashkimin e tokave nuk kanë pushuar anjëherë e nuk do të pushojnë kurrë. Shqipëria Etnike është ideali ynë kombëtar.

Pjesëmarrësit, i përgëzojë ,në këtë ditë të shënuar edhe n/kryetari I Shoqatës Atdhetare Dibrane z Muharrem Borova. "Jemi mbledhur sonte, këtu për t'i zgjatur dorën njëri tjetrit, dhe për të kujtuar atë ditë, tha ai kur u ngrit në Vlorë flamuri ynë kombëtar. Për këtë qëllim, viojë Borova, faleminderojë, edhe një zonjë të madhe, e cila me vullnetin e saj të palodhëshëm ndihmon Shoqatën Atdhetare "Dibrane".dhe komunitetin tonë, pikërishtë ajo zonjë e cila me luftë e skarifica , pa asnjë lloj pretendimi e interesi, është nga hera pranë nesh, ajo është Shyrhete Haskaj.

Në këtë mbrëmje të shejntë - shoqata Atdhetare "Dibrane", foli Borova, e cila në gjirin e saj tubon dibranët e Amerikës, ka krijuar traditën e saj me organizmin e festave të tilla, kombëtare, ku bie në sy festa e flamurit - shpallja e pavarësisë së Shqipërisë. Festë, e cila, këtë ditë të madhe të gëzimit tonë, të ditës së shënuar , ka mbledhur shumë dibranë të moshave e gjinive të ndyshme. Por, kësaj rradhe, theksoi ai me pjesëmarrjen e vet, ne na kan nderuar edhe shumë vëllezër e motra, nga Prishtina, Vlora, Tirana, Fieri, Korça, Pogradeci, Përmeti, Durrësi, dhe Çamëria., për të gëzuar së bashku këtë ditë të shenjët të 28 Nëntorit.

Mëpastaj mbremja festive kaloj në programin artistik.

Për argëtimin e kësaj mbrëmje festive disponoi argëtimi me shumë profesionalizëm e mjeshtëri, nga orkestra muzikore e grupit Alba, në drejtimin e Edmond Xhanit, me këngëtarët, Irma Libohova, Luljeta Pëllumbi, dhe Muharrem Borova. Mysafire speciale kësaj mbrëmje festive ishte këngëtarja nga Tirana, Irma Libohova. Nëpërmjet këngëve, melodive e valleve interpretuar prej tyre, ata sollën me plot embëlsi, kënaqësin e dëshiruar duke e bërë festën edhe më të bukur. Përveçse valleve, melodive e kenget popullore nga te gjitha viset, dhe interpretimin e shkëlqyer të këngëtares nga Tirana, e bënë edhe më entuziaste e më të gëzueshme këtë mbrëmje, edhe fëmijët e talentuar Sara Gjurkaj(Xhelali) e bija e këngëtares Lujeta Pëllumbi, dhe Justice Zoto.

Dy Dibrat kremtuan madherishëm Ditën e Pavarësisë dhe të Flamurit

Nga **REXHEP TORTE**

95 vjetori i Ditës së Pavarësisë dhe Dita e Flamurit Kombëtar Shqiptar në Dibër të Madhe në Maqedoni dhe në Dibër të Vogël-Peshkopi në Shqipëri, u shënuan bashkarisht dhe në mënyrë dinjitoze. Më datë 28 nëntor 2007 në mesditë një delegacion nga Dibra e Madhe i udhëhequr nga kryetari i komunës Argëtim Fida mori pjesë në solemnitetin e organizuar për nder të 28 Nëntorit në Dibër të Vogël-Peshkopi.

Fillimisht Ilir Krosi, kryetari i Bashkisë së Dibrës së Vogël-Peshkopisë dhe Argëtim Fida, kryetar i Komunës së Dibrës së Madhe bënë homazh dhe vunë kurorë me lule te lapidari i Elez Isufit, gjeneralit me shajak,siç e quanin asokohe, i cili ua fuste tmerrin ushtrive serbe. Pastaj të paraprirë nga banda muzikore frymore vendase parakaluan rrugës kryesore për në sallën e koncerteve në Qendrën Kulturore.

Ilir Krosi, kryetar i Bashkisë së Dibrës së Vogël-Peshkopisë në akademinë solemne kushtuar 95 vjetorit të Pavarësisë dhe 63 vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë , deklaroi se:" Çdo popull ka kujtesën e tij historike. Historia e një populli është element thelbësor i identitetit kombëtar. Shqiptarët historikisht janë karakterizuar nga vitaliteti, konsistenca dhe aftësia për të tejkaluar presionet asimiluese që i kanë ardhur nga pushtuesit e huaj.Mbetemi krenar me Skenderbeun legjendar dhe birin e Dibrës që mbrojti tërësinë tonë territoriale dhe ishte barierë e sulmeve ndaj ndaj Evropës dhe qytetërimit perëndimor. Në Nëntor të vitit 1443 Skenderbeu ngriti flamurin shqiptar në Kuvendin e Lezhës, duke dhënë modelin e kombit që luftonte robërinë. Në gjysmën e Dytë të shekullit 19, elita shqiptare e shkolluar në Turqi dhe Perëndim, do të niste Rilindjen Kombëtare me Sami Frashërin, Vaso Pashën, Naum Veqilharxhin etj., duke trasuar platformën e shtetit të ardhshëm shqiptar. Kjo lëvizje do të kulmonte me Lidhjen e Prizrenit në vitin 1878 ku Iljaz Pashë Dibra, Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi etj., do të bënin përpjekjen madhore për mëvetësimin nga Turqia dhe formimin e shtetit shqiptar. Në agun e shekullit 20 Shqipëria,e veçanërisht Dibra dhe Kosova, do të viheshin në ballë të kryengritjrve për liri e pavarësi. Haxhi Vehbi Dibra dhe Dom Nikollë Kaçori, u bënë figurat kryesore të Qeverisë së parë të kryesuar nga Ismail Qemali me ngritjen e Flamurit më 28 nëntor 1912 në Vlorë. Do t'i vlerësojmë personalitetet, shtyllat e kombit tonë, sepse një komb që baltos dhe fyen personalitet e tij historikë është i destinuat që të humbas".

Argëtim Fida, në fjalën e tij përshëndetëse, theksoi se:"Flamuri i kuq gjak dhe shkaba dykrenare është brojtur ndër shekuj me gjak dhe flamuri shqiptar është i lashtë sa edhe vetë shqiptarët. Flamuri ynë ka edhe hymnin e vet rreth të cilit bashkohen të gjithë shqiptarët kudo që jetojnë. Sot festojmë bashkarisht që të kuptojnë të gjithë se jemi një komb që kemi një kulturë e një flamur dhe që ky flamur do të valojë poërgjithmonë aty ku janë shqiptarët. Me këtë flamur luftoi Piroja, Skenderbeu, Azem Galica e bajram Curri, Adem Jashari e Ali Ahmeti dhe po këtë flamur shqiptarët do ta valvisin në çdo betejë po qe nevoja. Këtë flamur nuk arritën ta zhdukin as romakët, as otomanët dhe as sllavokomunistët me vrasje e burgosje. Askuj të mos i shkojë ndër mend se do të mund ta ndalojë të valojë flamuri ynë kombëtar. Shqiptarët



Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe, z. Argëtim Fida dhe Kryetari i Bashkisë së Peshkopisë, z. Ilir Krosi, duke vendosur një kurorë te lapiari i Elez Isufit

nuk janë fajtorë për padrejtësinë që u është bërë e që sot jetojnë në gjashtë shtete, por në trojet e veta ku si autoktonë valvisin flamurin e tyre. Sot festojmë 95 vjettorin e Pavarësisë së Shtetit Shqiptar, të shtetit amë, kujdestares së të gjithë shqiptarëve kudo që janë. Ky vit jubilar koinçidon edhe me Pavarësinë e Kosovës të cilën e meriton me gjakun e derdhur për liri".

Premtim Kryemadhi, kryetar i Këshillit Bashkiak të Dibrës së Vogël-Peshkopisë i njoftoi të pranismit me Vendimin e Këshillit Bashkiak të datës 8 dhjetor 2007 drejtuar Kabinetit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, për të dekoruar me medalje nderi (ose rivlerësim urdhërash) "Për veprimtari patriotike", për kontributin e dhënë dhe aktivitetin patriotik në Shpalljen e Pavarësisë personalitete nga Dy Dibrat.

Për dhënien e Urdhërit "Flamuri Kombëtar" janë propozuar Vehbi Ahmet Agolli (Dibra), Dom Nikoll (Vokërr) Kaçori dhe Elez Isuf Ndreu. Për dhënien e Urdhërit "Gjergj Kastriot Skenderbeu" janë propozuar Xhemile Hasan Xhogjegja, Osman Tahir Paci, Elez Sadik Koçi dhe Mersim Mustafa Dema. Për dhënien e Medaljes së "Artë të Shqiponjës" janë propozuar Hafiz Sherif Langu, Ismail Pashë Saraçi (Dibra), Selim Dalip Rusi, Bajram Dali Buci, dhe Hamdi Luman Ohri. Për dhënien e Medaljes "Pishtar i Demokracisë" janë propozuar Mislim Ahmet Çerpja, Qamil Selim Daci, Hajredin Haziz Hoxha, Shahin Lam Daci, Ali Shaban Kaca, Rushit Sadik Sina, Sefedin Nurçe Pustina, Shehat Ymer Shehu, Isuf bej Hysenagolli, Aqif Selim Rusi, Ramiz Iljaz Pashë Dibra, Mane Rexhep Torba (Çenga), Hafiz Maliq Tanusha dhe Kurt Nel Hoxha.

Rexhep Cara, kryetar i Vetëranëve të luftës përt Dibër të Vogël-Peshkopi, në emër të Komitetit të Veteranëve të Luftës antifashiste për kontributin e tyre gjatë LAÇ dhe gjatë rindërtimi të vendit,shpalli të dekoruar me titull të lartë Ramadan Dukën dhe Irfan Fidën.

Moisi Kamberi, historian nga Dibra e Vogël-Peshkopi në referatin e tij lidhur me rrugëtimin shqiptar drejt pavarësisë, theksoi se:"Dibranët janë përfaqësues të denjë në shpalljen e Pavarësisë. Si rezultat i sakrificave të pashembullta , të gjakut të derdhur në çdo skaj të Shqipërisë, u realizua ëndra e shumëpritur Pavarësia. Dibranët gjatë shekujve të sundimit e deri në prag të pavarësisë do të jenë në mbrotje të trojeve shqiptare dhe në ngjarjet vendimtare historike kombëtare. Dibra dhe dibranët me udhëheqësit e tyre do të jenë në qendër të përcaktimit të fateve të kombit. Nëntë Malet dinin të kuvendonin , të falnin gjaqet dhe të lidhnin besën sa herë që atdheu ishte një rrezik. Shpallja e pavarësië nuk mund të kuptohet pa praninë e dibranëve. Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e Pejës, Besëlidhja e Dibrës, Kongresi i Dibrës dhe Kryengritjet e viteve 1910/12, ishin qendra e brojtjes së trojeve shqiptare dhe mbështetësit kryesore të Lidhjeve Shqiptare.Pas pesë shekujve sakrificë Ismail Qemali me shokë e kuptuan se e vetmja rrugë për ta shpëtuar Shqipëriunë është Shpallja e Pqavarësisë".

Mois Murra, historian nga Dibra e Vogël-Peshkopi, në trajtesën e tij lidhur me kontributin e dibranëve për pavarësi, shtoi se:" duke e mbrojtur Flamurin tonë kombëtar, mbrojmë territoret tona etnike. Pas shpalljes së Pavarësisë qindra mijëra ushtarë serbë të armatosur me qindra mijëra armësh altilerike, sulmuan Kosovën, Dibrën dhe Shqipërinë. Asokohe Dibra nëntë vitë rrjesht luftoi kundër hordhive serbe të divizioneve të Shumadisë dhe Moravës. Për fat të keq në këto luftëra të pargjakshme dibranët nuk u ndihmua nga asnjë krahinë tjetër shqiptare. Kontributi i dibranëve për Pavarësinë e Shqipërisë është të shumë i madh dhe për këtë flasin dokumnete të shumta historike dhe faktografike".

Ramadan Ymeri, historian nga Dibra e Madhe, në trajtesën e tij, "Kryengritja e Shtatorit 1913 në Dibër,u shpreh se: "Dibra një vend i lidhjeve ekonomike, kulturore dhe i kuvendeve , dëshmoi nivelin më të lartë kombëtar që në kohët e lashta e deri në ditët e sodit. Pas Shpalljes së Pavarësisë në vitin 1912 shumë treva shqiptare kishin mbetur jashtë Shtetit Shqiptar, mes tyre edhe Dibra.Dibranët për ta mbrojtur vendin nga okupuesit serbë vazhduan rezistencën e tyre të armatosur duke protestuar kundër Konferencës së Ambasadorëve në Londër, duke kërkuar që Dibra të mos i lihej Serbisë. Fuqitë e mëdha nuk i morrën parasysh kërkesat e dibranëve, kështu që Elez Isufi sëbashku me patriotët tjerë, organizuan Kryengritjen e Shtatorit të vitit 1913. Dibranët i sulmuan pozicionet serbe, ndërsa në qytet u zhvilluan luftime trup me trup dhe serbët lanë të vrarë qindra ushtarë. Flakët e kësaj lufte u përhapën edhe në territoret tjera shqiptare ku vajtën për të ndihmuar afër 12 mijë dibranë".

Në këtë akademi solemne u shfaq një montazh i bukur tematik letraro-muzikor nga artistë të dy Dibrave, Ylber Nuredini, Ejona Torba dhe Lundrim Paçuku. Ndërkaq mori pjesë edhe orkestri i instrumental nga Dibra e Vogël-Peshkopia me pjesë muzikore , në përbërje të Faik Vojka-klarinet, Majlinda Vraniqi-flautë , Sokol Seferi-violinë, Hysen Seferi –fisharmonike dhe Ymet Seferi drejtues orkestre.dhe tenori Mustafa Imeri dhe pianistja Elena Siljanoska nga Shkupi. Në këtë spektakël interpretoi këngë të muzikës serioze tenori Mustafa Ymeri i shoqëruar nga pijanistja Elena Siljanovska, që të dy nga Shkupi.

Me këtë rast në Dibër të Vogël-Peshkopi, kryetarët e Dy Dibrave sëbashku me deputetin Rahim Kaleci , vizituan familjet e policëve Zenel Xhetan Premçi nga Muhuri dhe Rifat Shefik Iskurti nga Polloz-hani të rënë në detyrë, njëri në vitin 2002, e tjetri në vitin 1998, për tu shprehur familjarëve ngushëllimet e përzemërta.

Akademi solemne me të njejtin program u mbajt mbrëmjen e datës 28 Nëntor 2007 në Dibër të Madhe , në sallën e koncerteve të mbushur përplot, ku mori pjesë delegacioni nga Dibra e Vogël-Peshkopi me në krye kryetarin e bashkisë Ilir Krosi i shoqëruar nga deputeti Rahim Kaleci. Pas akademisë solemne qindra pjesëmarrës përjetuan edhe spektaklin e bukur me fishekzjarre për nder të këtij kremtimi madhështor.

Në dy Dibrat u shfaq edhe ekspozita me foto monumentale të figurave të shquara të historisë kombëtare shqiptare.



Moment nga ngushëllimi nëfamiljen e Zenel Xhetan Premcit



Orkestra Peshkopi, tenori Mustafa Ymeri dhe pijanistja nga Shkupi

Përkujtojmë 40-vjetorin e tërmetit katastrofal të Dibrës me rrethinë

Tik-taku i orës u ndal në 8 e 25 min

Nga **IBRAHIM EGRIU**

Sot, më 30 nëntor 07 mbushën plot 40 vjet nga dita kur një tërmet 9 shkallë i fuqishëm e kaploi Dibrën e Madhe me rrethinë, Dibrën ku ndodhet Kështjella e dytë e prisit tonë legjendar-Skënderbeu, Dibrën e Iljaz Pashë Qokut, kryetarin e parë të Lidhjes së Prizrenit, Dibrën e Suf Xhelilit e Seidi Najdenit, të Ramiz Dacit e Hoxhollit dhe Dibrën e shumë trimave e heronjve të tjerë që ranë fli në alltarin e lirisë.
Të gjithë dibranëve u është ngulitur thellë në kujtesë ajo ditë e llahtarshme plot trishtim e lemeri. Ishte ditë e enjte, ditë feste. Saktësisht, në ora 8-të e 25 min. të mëngjesit, një dridhje e fuqishme e përshkoi Dibrën me rrethinë. Në ato çaste s'dinim se ç'po ndodh! Lëkundje e fuqishme e tokës! Humbje e ekuilibrit! Britma, vrapime, ulurime e ofshama!
O Zot, ç'ndodhi kështu ! –Secili përpiqej të shpëtojë i gjallë. Plasaritje të mureve dhe derdhje të shtëpive, thyerje xhamsh, shkapërderdhje orendish, ndërsa nga dridhjet e fuqishme,tik-taku i orës u ndal në orën 8-të e 25 min.

DIBRA '67

Në ato çaste bashkë me Skënder Selën e Naim Dacin u gjendëm në Studion radio"Dibrës" që të dërgojmë një urim me rastin e diplomimit në Shkollën e Lartë Pedagogjike. Dikush bërtiti me të madhe:-Ikni!-Largojuni!-Askush s'dinte se ç'ndodh. Atëherë, vetëtimthi vrapova shkallëve tatëpjetë. Papritmas, nga shpejtësia u rrëxova dhe, duke u rrokullisë u gjënda në fund të shkallëve. Një dhëmbje të fortë ndjeva në këmbën e majtë, të cilën s'mundesha ta lëviz fare. Nga droja se do më zë muri, rrëshqanas dola jasht.

Ç'me pa!-Dibrën legjendare, me ato rrugë të pastra dhe godina të vogla dhe tërregulluara bukur e kish mbuluar pluhuri në të katër anët.Asgjë s'mund të shikoje nga pluhuri i madh. Ashtu duke çaluar, nisa në drejtim të rrugës kryesore të qytetit. Në të djathtë vërej godinën e Federatës gjysëm të rrënuar për tokë. Kudo derdhje, kudo shkatërime, kudo rrëmujë dhe në të gjitha anët mbretëronte qetësi. Pas ca çastesh dëgjoheshin refrene:-A jeni gjallë, a jeni gjallë!?

Rruga nga Shtëpia e Pionierëve ku ish vendosur radio-emisioni "Dibra" derite shtëpia ime ishte rreth katërqind metra. Ecja vetëm me një këmbë, kurse rruga më dukej tepër e gjatë. Në ato çaste traumatike, i cvilitur, i trishtuar dhe i zhytur thellë në mendime,vërejta mijëra dibranë, të cilët vërshonin turma-turma nëpër rrugë e qytetit dhe, me vrap ishin drejtuar tek më të afërmit e tyre që të mësojnë se ç'ndodhi me fatin e tyre. Në fëtyrën çdo qytetari pasqyrohej një dhe huti e papërshkruar.Në ato çaste dëgjohej vetëm një refren:

-A jeni gjallë, a jeni gjallë!?-Ndërsa askush s'pyeste për rrënimin e godinave dhe dëmtimin e orendive shtëpiake.

Të parin që e takova me të dalur në rrugë qe kapiteni dhe lojtari më i shquar i ekipit futbolistik"Korabi", patrioti i ndjerë, Muhamer Ballanca-Muja, i cili, porsa më vërejti në atë gjendje, menjëherit m'u lëshua në përqafim e më tha:-A je gjallë!?-Por, ç'ke në këmbë, ç'të ka gjetur?-Gjallë jam Mujë, gjallë-shpëtova!-Unë tha ai, vrapoj të shohë se çka ndodhur me të afërmit e mi në lagjen Manazjarr, por së pari do të ndihmoj Ty që të të përcjell deri në shtëpi se kështu s'ke se si të arrish me një këmbë!-Jo, Mujë, të falemnderit, por dhe ti je i brengosur për të afërmit e tu, dëshirosh të dëgjojsh se çka ndodhur me jetën e tyre, andaj mund të shkojsh, ndërsa unë do arrij dalë nga dalë.

Jo,kursesi, unë do të përcjell deri te kinemaja e mandej vazhdo.-Ashtu dhe u bë. Më rroku për krahu dhe më përcolli deri në vendin e caktuar dhe shkoi.

S'i bëra as dy hapa kur paprtmas më doli përpara shoku im i ndjerë dhe shumë i dashur, Triumf Turkeshi, nipi i Eqrem Qabejt, përndryshe atdhetar i shquar, i cili gjithmonë ishte ferrë në sy për Sigurimin e atëhershëm monist. Ai gjat çdo manifestimi thirrej në polici dhe mbahem me ditë të tëra.Më përqafoi ngrohtë e më pyeti:-Ç'ke Imi, çka të ka ndodhur kështu?!-Asgjë Tufi,asgjë-kryesorja shpëtova!-Atëherë s'e zgjati shumë, më rroku për krahu dhe nisëm dalë nga dalë së bashku. Sa miq e të njohur takoja rrugës, me keqardhje më pyesnin se ç'ndodhi me mua.-Përgjigja ime ishte:-gjallë jam, gjallë, por s'di se çka ndodhur me fëmijët dhe prindërit e mij. Në ndëkohë, në rrugën „Liman Kaba", së bashku meTufin, e takuam edhe ish futbolistin e shquar të „Korabit", poashtu atdhedashës-Luan Camin, i cili vraponte të mësojë se çka ndodhur me motrën e tij, Fatbardhën dhe fëmijët e saj.

U ofruam pranë shtëpisë sime. Ç'me pa, muret për rreth shtëpisë derdhur për tokë dhe, akoma pa u avit te dera kujtova se të gjithë anëtarët e familjes ndodhen nën gërmadha. Në hyrje të shtëpisë, pranë derës më prisnin shokët e mij të ngushtë-Mentor Sefedini, Azis Azis Kërluku, Sami Gorenca, Petrit Dibra dhe Edip Sela, të cilët kishin ardhur që të marrin vesht se çka ndodhur me mua dhe familjen time.Ata, porsa më panë bërtitën me gëzim:

-Ja ku vjen Imi gjallë e shëndoshë dhe u lëshuan ë përqafim. Mandej, shikimin e përqëndrova ne mes të shtëpisë ku ishin grumbulluar tërë anëtarët e familjes dhe farefisi i ngushtë të cilët ishin brengosë së tepërmi për vonesën time dhe, me britma e lotë në sy brohoritën:

-A je gjallë?Po, po gjallë e shëndoshë jam!-Po ju, a jeni të gjithë në numër shëndoshë e mirë?-Po, u përgjigjën njëzëri të gjithë.-Ç'ke në këmbë, çka të ka gjetë?- Asgjë, asgjë do të kalojë. Kësaj i thonë fat në fatkeqësi.

Viktimat

-S'kaloi as një orë pas tërmetit, kur vetetimthi u përhap lajmi se nga tërë ajo dridhje e fuqishme e tokës, falë elektricistit hero dibran -Shuip Kobeci, i cili në atë kohë ndodhej në Centralin elektrik të qytetit, duke dashtë të shpëtojë djegien e shtëpive të dibra nëve dhe, duke mos parashikuar rrezikun e jetës që i kanosej, në shpejtësi, ndërpreu rymën elektrike dhe ra fli për të shpëtuar Dibrën e Madhe dhe qytetarët e saj, për të mos vdekur kurrë. Për këtë trimëri dhe heroizëm që tregoi heroi Shuip kobeci, këngëtari i mirënjohur dibran, Haxhi Maqëllara i thurri këngë.Andaj, Dibra ia ka borxh Shuipit që tia ngre një përmendore. Të gjithë dibranët me pietet të thellë pranuan lajmin e idhur për vetësakrifikimin e heroit Shuip Kobeci, i cili lë pas dy djem të bukur, bujar e të vyeshëm, të cilët sot pas 40 vjetësh kanë krijuar familjet e tyre. Poashtu, me pikëllim u bë e ditur vdekja e djalit 9 vjeç e fizarmonistit të Shoqërisë së përmendur dibrane "Liman Kaba", patriotit Eshtref Çutra.Mirëpo,mbi të gjitha damet e mëdha materiale që ndodhën, në tërë Dibrën me rrethinë pati vetëm katër viktima, kurse secili dibran thoshte:-patëm fat në fatkeqësi, sepse, 30

nëntori ishte ditë pushimi dhe nxënësit s'ndodhën nëpër shkollat e tyre.

Ndihmat e para

- Një prverbë popullore thotë:-Mos të lashtë Zoti pa tëndin! Kjo thënie u bë realitet me rastin e tërmetit.Njeriu i parë, i cili në emër të kaçanikasve ia ofroi ndihmat e para në Dibër qe ish krytari trim e patriot-Sali Bajra, të cilin dibranët e quanin engjëll.Ai, në orët e pasditës erdhi vetë në Dibër dhe, para shtëpisë së ish kryetarit të ndjerë dibran, Ismailhaki Mullau, i ndali kamionët me miell, batanie e ushqime dhe iu drejtue popullatës dibrane me këto fjalë:-çdo familje dibrane është e mirë se ardhur në gjirin e familjeve tona. Pra, ju presim të na vini, me bukë, krypë e zemër. Si tha ashtu dhe u bë. Shumë familje dibrane me muaj të tëra u strehuan në kaçanik. Atë mirësi që ua bëri dibranëve ish kryetari i Kaçanikut, popullsia e kësaj treve s'do ta harroj kurrë.

Pas ndihmave të para që i solli atdhetari legjendar-Sali Bajra, filluan të vijnë dhe ndihma të tjera. Shumica e dibranëve mendonin se tani e ka radhën edhe Dibra, sikurse Shkupi të rindërtohet siç duhet, sepse Dibrën gjithmonë e trajtonin si zorrë qorre të ish Jugosllavisë.

Fillimisht, për shtëpitë e dëmtuara rëndë u ndanë ndihmat e para prej 500 mijë dinarësh. Dikush e shfrytëzoi këtë të drejtë e dikush jo. Megjithë se gjysma e shtëpisë sime u rrënua plotësisht për tokë, unë atë të drejtë nuk e shfrytëzova, sepse, siç më thuhej në vendimin e Komisionit se, gjatë asaj kohe paskam pasë qenë i punësuar si mësues në komunën e Gostivarit dhe s'paskam pasë të drejtë t'i shfrytëzoj; por vetëm se më mundësohej që të huazoj kredit në shumë prej 1milion e 500 mijë dinarësh. Si më urdhëruan ashtu dhe u bë..me ato të holla ndërtova një strofull sa me e mbuluar fëmijët e mij kokën, sepse kështu shkruhej në ligjin e Komisionit për shpërndarrjen e ndihmave. Dhe sot e kësaj dite më është ngulitur thellë në kujtesë paraqitja e një ish robaqepësi dibran, i cili, pak kohë pas tërmetit m'u drejtua me këto fjalë:"Imi, ti koxha prof. kurse shtëpinë e ke si kasolle, pse s'e ndërtosh një më të mirë"?!-Përgjegja ime qe:-Po, e vërtetë është se ne mësuesit jetojmë në kushte të tilla dhe jemi fukarenj, por të mëdhenj në shpirt. Gjatë pushimit veror isha në vendlindjen time të dashur dhe plot pas dy dekada flejta në strofullën time të ngrohtë.

Zhgënjimi i dibranëve

Edhe pse Dibrës i arritën mjaft ndihma si nga brenda, poashtu edhe nga jasht, përsëri, Dibra-zorra qorre, siç e quanin pushtetmbajtësit, mbeti njashtu siç ishte, ndërsa, se çka ndodhi me ndihmat, kush i shrytëzoi dhe kah i zhdukën, më së miri e dijë ata që ishin në pushtet, pra kolltukxhinjtë e asaj kohe dhe, ashtu siç dërgoheshin, ktheheshin prap nga kishin ardhur d. m. th. në drejtim të Shkupit.

Emruesi i përbashkët i gjithë atyre ndihmave që ia ofruan Dibrës, qe vetëm se ndërtimi i Pallatit të Kulturës në Dibër, të cilin, maqedonomëdhenjtë e pagëzuan me emrin"Skopje"-"Shkupi".

Malme-Suedi, më 30 nëntor 07

MA NDEZE MALLIN, OR BENI I ILNICËS



"...Dhe në vuaj, le të vuaj,
të mos vdes në dhe të huaj..."
Çajupi

Nga **ABDURRAHIM ASHIKU**

Kur mosha udhëton nëpër brezin e tretë, kur je larg vendlindjes ku "balta është më e ëmbël se mjalta", kur e lexon Naimin dhe Çajupin si bashkemigrant, një zë i largët të zgjon nga gjumi dhe të çon maleve të lartë…

Kjo më ndodhi para disa ditësh. Një zë nga ishulli i largët i Mitilinit, zëri i Arbenit nga Ilnica, më shkundi siç shkund era nga pemët flokët e dëborës së parë…

Arbeni më ngjiti në Ilnicë. Dibranët ia kanë dëgjuar emrin atij fshati në fole të Valivarit. Fshatrat fqinj, ato të Grevës e Melanit ia kanë pas zili bukurisë së atij vendi… Unë e kam jetuar Ilnicën në vitet e herëshme të fëminisë dhe në vitet e burrërisë…

Thashë se është në "fole të Valivarit", një fole dallëndysheje që ka në pëllëmbë të dorës Dibrën mbarë. Është një ballkon i pallateve të mëdha të natyrës, maleve, që po të ulesh njëherë e të gjerbësh kafenë e mikpritjesh do të mbetesh atje.

Mbi Ilnicën është maja e Valivarit e në prehër të tij bjeshka më e bukur e vargmaleve që fillojnë nga Radika e Dibrës së Madhe e dorë për dore e krahqafë me njeri tjetrin lidhen me Korabin, bjeshka e Hynoskës. Uji i asaj bjeshke është një lot, një perlë jetëdhënëse. Plane të tëra qenë bërë që ai ujë të zbriste malet e të mbushte çezmat e qytetit të Peshkopisë. Në fund ishin zbrapsur. Uji nuk mjaftonte për të plotësuar nevojat e së ardhmes së qytetit asokohe me një industri ushqimore e mekanike mjaft të zhvilluar. Për qytetin u zgjodhën burimet e kristalta të Korabit, burime më se dyzet kilometra larg…

Uji i bjeshkëve të Hynoskës mbushi tubat e zbriti duke shkumbëzuar çezmat e Ilnicës, Grevës, Melanit, Pjeçës e Pejkës aty nga fundi i viteve tetëdhjetë. Kam qenë atje dhe kam parë gratë e fshatit të mbushnin ibrikët e shtamat. Kam parë edhe burrat e fshatit të shtrinin tubat e ta fusnin ujin e bekuar brenda shtëpive. Ishte një ndër bukuritë që ta mbushte shpirtin e ta bënte mal.

Nga ballkoni i Ilnicës nuk ka se si të mos shohësh dy sy të kaltër, dy liqene artificialë ngritur në truall të Melanit e të Trepçës. Ata ishin jo vetëm një bukuri por edhe një begati për tokat e fshatarve por edhe për njerin prej blloqeve më të bukur frutorë të Dibrës, bllokut të kumbullave,dardhave, mollëve, gështenjave e arrave të Qenokut. Më ka takuar që në vitet 1966 – 1967 në atë bllok të hedh piketat e bashkë me brigadjerin Rustem Xhajku dhe mjeshtrin e madh të pemtarisë Dibrane Xhavit Hysën t'i vemë në rrjeshta të drejta pemët. Vite më vonë, për të mbledhë e dërguar në treg apo për përpunim industrial kumbullat e Qenokut duhej një përqëndrim forcash të ndërmarrjes bujqësore e të kooperativës së Melanit por edhe të nxënësve të shkollës së mesme bujqësore të Peshkopisë. Qenoku asokohe numëronte pesëdhjet e tre mijë rrënjë pemë frutore në blloqe të organizuara. Tani, po të mos ishte ndërhyrja e menjëherëshme e ish pronarëve të zabeleve, Qenoku do të kishte pamjen e blloqeve frutore të Gjarajcës, Pasmarit , Zdojanit, Sinës, Kastriotit, Kubenit, Kabeve etj. kur cungjet e prera të pemëve të duken si kunjat e varrit të një varreze parahistorike luftëtarësh me sopata e hanxharë. Këto blloqe, njeri më i bukur se tjetri mbanin në fillim të viteve '90-të në rradhë mbi pesqindmijë pemë frutore, dy të tretat e të cilëve ishin në prodhim të plotë…Kafen e zezë të kësaj masakre e piu me kënaqësi barbare politika e viteve l991 – l994….

Zbritëm rrokullimthi nga Ilnica dhe morëm tatpjetën kodrave të bukura të dikurshme, me dashuri dhe me hidhrim. Më duhet përsëri të ngjitem lart. Ma detyroj ngjitjen Arbeni, djali i Ilnicës…

Tek bisedonim në telefon, bashë takuam në disa emra, njerëz të zemrës që ai i njihte nga afër. Takuam Sadull Nurçen dhe të birin Bajram Nurçen. Sadulli ishte kushëri i parë i babait tim. E donin shumë njeri tjetrin ashtu siç donin të dy së bashku kushëririn tjetër, Azem Poçin nga Erebara. Azemi ishte njeriu më punëtorë që kam njohur në jetën time, njeriu më puntorë në të gjithë bujqësinë shqiptare të asaj kohe. Këtë e them me bindje të plotë sepse ai njeri mori në atë kohë pensionin më të lartë që njihej në bujqësinë kooperativiste. Erdhën për të vërtetuar saktësinë e pensionit inspektorë nga Tirana, nga sigurimet shoqërore e kontrolli i shtetit. Të gjithë ikën pa ndryshuar asgjë, me respekt të pakufishëm për njeriun e punës.

Me Sadullin më lidhin kujtime të herëshme të fëmijërisë, ditët e pushimeve dimrore kur ngjiteshim malit me dëborë të Ilnicës e u gëzoheshim fëllanxave të malit që Ai i kapte me dorë. Më lidhin edhe kujtimet e rinisë kur Sadulli punonte në sektorin e Qenokut të NB-së e sa e sa herë kujtonim ditët e bukura që kisha kaluar në Ilnicë.

Bajrami, më tha Arbeni , është në Lamia bashkë me të birin dhe janë "zënë mirë". Nuk ka si të ndodhëte ndryshe, dardha do të binte nën dardhë. I kërkova numrinn e telefonit por ai nuk e dinte. Më premtoi se do ta gjente.

Diku, në arkivin tim fotografik, kam edhe një pamje të begatisë së Ilnicës. Sa herë e marr në dorë atë fotografi më duket sikur kam fiksuar në celuloid një përrua gurëshumë pas vërshimeve pranverore. Nuk janë gurë prroi por patate, një bimë që ka lidhë në një pjellorinë e tokës dhe duart punëtore të grave dhe burrave të Ilnicës.

Ilnica ka edhe një shtëpi kulti. Teqja e Ilnicës është një ndër Shtatë Teqet në zë në Dibër. Betimi i burrërisë dibrane "Për Shtatë Teqet" ishte betimi më i rëndë pas të cilit fshihej vetëm e vërteta. Në Teqen e Ilnicës, në vitet e fëmijërisë së herëshme, qesh mbyllur për disa minuta edhe unë. E bënë këtë Nëna e Babai, bashkë me Sadullin e të shoqen, që të bëhesha fëmijë i mbarë…

Ai zë nga Mitilini i largët më zgjoi malle të fjetura, m'i ndezi ato duke më dhënë jetë…

Nuk do t'i kisha shkruar këto rradhë nëqoftëse ata do të ishin vetjake, të mijat. I shkruajta sepse me ndryshim adresash e emrash njerëzish, janë edhe tuajat, janë të çdo emigranti. Ata janë nyja prej çeliku që na mban lidhur me dheun e nanës dhe të babës, që na tërheqin drejt vendlindjes, drejt fushave e maleve të Shqipërisë….

SHENIME TE NJE EMIGRANTI

Homazh për Ilmi Latën

Nga **ABDURRAHIM ASHIKU**

- Në 15 vjet, me 2 – 3 kalime në vit, Ilmi Lata nga Katundi i Ri i Dibrës, ka kaluar maleve të Greqisë 30 – 40 herë, një rekord i emigracionit shqiptar...

Ekam në sy Luzninë që ditën që vështrimi im u bë i ndërgjegjshëm, që kur fëmijë ende i vogël dilja në kodër pak metra larg shtëpisë time dhe vështroja fushën e Çapit, shelgjishtet dhe vrrinishtet në deltën e Drinit kur hapte krahët i çliruar nga ngushtica e Hoteshit dhe i mbyllte ato kur futej në ngushticën e Muhurrit.

Më vonë kur kapa metrin e gjatësisë trupore, kur munda të kaloj shelgjishtet dhe vrrrinishtet e të hyja mes dallgëve të Drinit me dy kunguj ujzë në të dy anët e mesit, mjeti praktik i kohës për të mësuar notin, kur një ditë gushti do të arrija ta kaloj lumin e të futesha mes lajthishtës për të mbledhur kokrrat e arrira, do të shkelja për herë të parë në tokën e Katundit të Ri.

Më vonë, në rininë time, kur do të emërohesha agronom në lokalitetin e Muhurrit do të shkelja për herë të parë fshatrat e Luznisë: Katundin e Ri, Arapin e Poshtëm dhe të Epërm, Lishanin e Poshtëm dhe Epërmin dhe të fundmin, Hoteshin prapa një zabeli dushku do të futesha në "klasën e parë" të shkollës së Luznisë.

Do t'i kthehesha odës së kësaj shkolle disa vite më vonë, kur isha burrëruar dhe kisha mësuar të lexoja e të përktheja fjalën fluturake të kësaj shkolle, të gjeja midis fjalës alegorike fjalën e mençme të popullit që ishte rritur e përcjellë brez pas brezi.

Luznia është një nga vendet më të varfra të Dibrës. Katundi i ri atë copë tokë që ia kishte falur natyra e kishte në mëshirën e Drinit. Ujërat e tij herë ia jepnin e herë ia merrnin, herë ia përcillnin Cetushit, Ushtelencës e Brezhdanit e herë ia kthenin atij. Kjo derisa një pritë e betontë ia ndali hovin e uji mori të rrjedhë mes për mes deltës së gjerë. Hoteshi në atë copë që zotëronte mbillte misër e perime. Qepët, specat, kastravecët...e Hoteshit ishin në krye të tregut. Dy Arapët, i Poshtmi dhe i Epërmi, Dy Lishanët, i Poshtmi dhe i Epërmi dallohesin për arrat dhe dardhat dimërore që me rrënjë mbanin mejat e tarracave dhe me fruta " Bukën " e fëmijëve. Them " bukën " sepse (siç do të mësoja kur të formohesha me dije shkencore, vlera e një kilogrami arra është e barabartë me vlerën e shtatë kilogramëve mish gjelle dhe ato katër kokrra – një vole – arra që nëna i fuste fëmijës në çantë për ta ngrënë në pushimin e gjatë të mësimeve ishin baras me katër qofte)...

Me kaq sa u kishte dhënë natyra atyre fshatrave jeta ishte e vështirë. Ata, për ta përballuar atë, për ta mbajtur në këmbë, i ngjiteshin malit të Pratit dhe prisnin drurët e mëdhenj të ahut për lëndë ndërtimi e dru zjarri, zbrisnin në Minierën e Mermerit dhe prisnin kubet e mëdhenj disa tonësh që merrnin rrugët e Evropës e shkonin deri në Japoninë e largët. Damari i kuq i atij mermeri ishte i famshëm dhe i kërkuar edhe në një vend të tillë si Greqia, edhe në një vend të tillë si Italia të përmendur në mijëvjeçarë për karrierat në qiell të hapur të mermerëve të bardhë. Luznakët ishin të lidhur me mirëmbajtjen e pyjeve, me kërkimet gjeologjike, madje edhe me vepra të tilla të mëdha si ato të Vaut të Dejes, Fierzës e Komanit si çarës të zotë të tuneleve. Kishin edhe një spital në Katund të Ri. Kishin edhe një shkollë të mesme në Lishanin e Poshtëm...

I kam jetuar dhe studiuar këto në udhëtimet dhe në bujtjet e shumëta në familjet luznake, i kam studiuar e ruaj shumë shënime për jetën dhe njerëzit e kësaj treve ku ka lindur dhe ka rrënjë të thella Alegoria Dibrane.

Nuk e di në se i din lexuesi rrënjët e njërit prej romaneve më në zë të shkrimtarit devollit Dritëro Agolli. " Njeriu me top " u mor nga Luznia për tu përcjellë në historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare si personazh i veçantë popullor. Emrat e heronjve të Dritëro Agollit janë emra të fiseve të Luznisë, emra të fisit Mate e Gruda, Fizi e Mera...

Dritëro Agolli mortajën që hodhi predhën nën shënjestrën e një punëtori – rob italian nga Arapi i Poshtëm në Lishanin e Poshtëm, në drejtim të kullës së fisit Mere, e bëri TOP. Plaku Mere dhe Mato Gruda janë pjesë e një historie të gjatë vëllavrasjesh që thonë se ka marrë 36 jetë, nga njëra e tjetra palë...

U zgjata shumë në histori, në kujtime të hershme. U zgjata për të thënë se Luznia e varfër në burime jetese një ditë, kur çdo burim pune në zonë do të shuhej, kur do të mbyllej miniera e Mermerit të Kuq dhe puna në pyjet e Pratit, do ta ndjente veten të varfër e më të varfërve. ▶

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE



Qari i madh në Shumbat



Zane Hata ishte një burrë i mençur e i provuar në një dëng me histori të buta a të ashpra, siç i kishte përjetuar e ndjerë në jetën e tij të gjatë. Erdhi një kohë që, kur ndonjëri donte të dinte për ngjarje e hollësria të tjera që kishin ndodhur në tërë krahinën, të çonin drejt e te Zania:

-Pyet një herë Zanen, se ai e di!

E gjeta Zanen nën hijen e manit, në oborrin e shtëpisë së tij, që rrinte ngreh e shkreh në atë rrëpirën poshtë fushës që të zbret drejt e në përrua.Këtu kalonte orët më të shumta të ditëve të gjata të verës, mbush e derdh çibukun me atë duhanin e zi katran.Dhe, si mbushej mirë e mirë me tym, fillonte të tregonte me frymëzim djaloshar bëmat e mëdha, por dhe ndonjë nga ato historitë e vockla që të mbushin me ngazëllim.Atëherë buzëqeshte pak dhe herë me dorën e majtë e herë me të djathtën tregonte si t'i kishte aty pranë, këtu-atje, ky-kjo, atë mot-atë ditë, ngjarje, vende, kohëra... Por, kur të thoshte "tahaj, nij këtu [1], o voc", duhet ta shikoje drejt në sy, se...

-Tahaj, nij këtu, o voc! Këtij i thonë Shumbat i kuq, se i kuq ka qenë e i kuq, asht. E shikon. Këtej ka rrjedhë shumë gjak, e mbushi pil për pil Drinin. Andaj i thonë i kuq, jo se është kuqlinë, - dhe tregonte një grusht dhe që e rrëmonte me ato gishtërinjtë e trashë në tokën poshtë postiqes.

-Këtu poshtë, mbaj Rrethas, ja njiktu, te kjo fusha jonë, ia thyem hundën Evranozit. Ia rratosëm nja 20 mijë kujkuq [2].

Kishim dhe ne Xhakovin (Jakovin) tonë me Gjergjin, se Kastriotin e kishim vëlla. Xhakovi na u vra, po atë ditë. Ishte qershor. Eh, ka shumë vjet, mbi 300 e sa. Djalë i ri Xhakovi... Ka pas dhe një këngë, por unë s'e mbaj mend. Prandaj asaj mëhallës përtej në kodër i thonë Xhakovinë ose Jakovinë, si këta të rinjtë. Baba, bile, më thoshte se e mbuloj gjaku krejt vendin, prandaj u thirr Xhakovinë...

Këtu siç bënte zakonisht në raste frymëzimi, përplasi fort shkopin dhe ngriti zërin:

-Pastaj ke Pozharin, gjak e hi. Ke atë Gurin e Nuses, i kuq. Pastaj, ja ku ke Shkekën e kuqe. Hë, sa serb kemi vra! Asnjë i gjallë nuk e kaloi këtë derë...

- Or mixha Zane, bre, po ky "qari i madh në Shumbat", si na mbet?

- Po kruhesh si fort, me mixhën.Po dhe këtë ta tregoj... Se, ta marrësh vesh ti, ky asht vatan që nuk blihet me pare. Kush i ka ba hyzmetin, i ka marrë bereqetin. Pse, a pak fise erdhën e gjetën rahmet në Shumbat?! Poooo, qari i madh në Shumbat si të duket? –Dhe buzëqeshi pak. Se si më dukej Zania?! Kur qeshte bëhej më i pashëm, më fisnik, më madhështor.

Kada me Hatën kishin qenë vëllezër.E donin fort njëri tjetrin, s'i ndante topi.Kur bënë bilik [3] morën kurbetin, si të gjithë aso kohe. Zunë një farë pune në Stamboll e me ato pak fitime, një herë në dy vjet, kthehej njëri vëlla në shtëpi, që t'u sillte harxhe familjes. Kështu, pas katër vitesh i ra shorti të vinte në shtëpi Hatës me ato mexhideje që kishin mbledhur vëllezërit. Apo s'ishin dhe të martuar e me fëmijë, e kishin një thes me halle. Rrugën e bënin në kambë atëherë. Pas shumë ditësh udhe mbërrin në Shehër të Dibrës dhe qëndron një natë te miku i babës, një farë Nurçe beu, i thoshin më duket. Ishte tregtar me emër ky Nurçja, por edhe i respektueshëm, me dyqane e saraje kasabe si askush. Tregonin se hanëmet bejleresha varnin qafës dy teneqe alltan. Hyje me mend e dilje pa mend në konakun e tij. Hatën e kishte pas respektuar shumë, ky Nurçe beu, se gjyshi i tyre, rahmet pastë, kishte shti pushkë nji ditë pazari, kur do hajna Radike kishin dashtë t'i vidhnin dyqanin ditë me diell. Njënin hajn e kishte mbajtë pushka e Hatës dhe ia kishin njoftë surratin. Qysh atëherë Hatja i Parë e kishte derën çelë e kryevendin në konak. Nejse...

Hatja, i lodhur nga rruga, u ngrit në mëngjes dhe vuri re zonjën e shtëpisë që po vishte mbi dimitë e mëndafshta dhe xhumlekun mavi anterinë 4) që i mbulonte si me zor trupin e bëshëm deri në lakun e gjurit. Pastaj hodhi qafës si shall një lëkurë dhelpre, tamam si ato dhelprat që dilnin shpesh te Guri i Shqipes tek kulloste dhitë, kur ishte fëmijë.

Xhemile - hanëmja merrte e jepte për për ta ujdisur siç qe më e mira atë shall lëkure dhelpre me push kadife, si të ishte pasuria më e madhe që po zbukuronte shtatin e saj. Nga dera gjysmë e hapur shifte e shifte zonjën tek i bënte hyzmet asaj cope lëkure, që për të s'vlente asnjë grosh. Por belaja ku s'të çon. Dhelpra rrëshqiti nga supet dhe u rras në një muslluk [5] uji, që e zemëroi pa masë Xhemile –hanëmen[6]. Dhe, siç e kanë zakon gratë, filloi të flasë me vete e të lëshojë shkulma nëmësh, që zgjuan edhe Nurçe beun që po bënte rehat-rehat gjumin e mëngjesit:

- U, të bëftë copa gërshana e Fik Terziut. Apo s'ke ba sa qimet e kresë?! Dhe filloi ta shkundë e ta pastrojë.

"Sa duhet të kushtojë vallë kjo copë lëkure, që gjendet me shumicë, atje në Shumbatin tim? - mendonte Hatja me vete dhe i shkonte mendja te ato shpellat e Gurit të Shqipes, ku hynin e dilnin dhelpra të mëdha e të vogla, me gëzof bojë hiri. Hates i punonte mendja. I mori leje Nurçe beut dhe doli në çarshi [7], e kërkoi dhe gjeti Fike Terziun, e shmangu paksa nga dyqani dhe e pyeti:

- Sikur të të sjell nja dhjetë lëkurë dhelprash, sa më jep?

- Po qenë të mira, ama?

- Të mira, të mira të jenë, që mos t'i ketë kush në Shehër.

Fike Terziu filloi të llogaritë duke belbëzuar e mbyllur sytë, sikur t'i jepte një hesap të saktë Hatës. Sigurisht, llogariste edhe fitimin e tij:

-Pesëdhjetë lira, o bir. Për pesëdhjetë lira m'i sill mua! - Pastaj, si e pa drejt në sy, e pyeti:

- Nga të kemi, o trim?

- Prej Shumbati jam, prej Dibrës së Vogël më ke.

Kështu u ndanë me Fike Terzinë dhe Hatja mori rrugën drejt shtëpisë së tij. E kishte mbledhur mendjen top, që këtij dimri të merrej vetëm me dhelprat, ta provonte këtë shans që i erdhi krejt papritur. Dy vëllezërit duke punuar atje tek perëndon dielli, natë e ditë, me bukë e pa bukë, i kishin bërë apo jo 50 lira turke secili në dy vjet. Lira aso kohe ishte një pare me vlerë. Me dy lira blije një ka njëqindkilesh.

Erdhi dimri. Murriza u mbullua me borë. Hatja i ktheu shpinën kurbetit dhe këtë vit do ta provonte qarin këtej rrotull. Bleu a rregulloi te usta Dila nja tri palë çarqe [8] sajoi shtigjet më të përshtatshme, duke gjykuar nga gjurmët që linin dhelprat mbi borë, hapi ca gropa në vendet kyçe, vendosi në fund të tyre çarqet duke i shtangur mirë e mirë, vinte mbi hatulla nga një parllak[9] coftine, lëshonte për t'i maskuar kashtë e byk dhe kur vinte mbrëmja kthehej në shtëpi, në vatrën e ngrohtë ku gjer afër mëngjesit digjeshin ngadalë kërcunjtë e dushkut që i jepnin një kënaqësi të veçantë tërë konakut. Ngrihej pa zbardhur mirë dhe merrte rrugën aty ku kishte ngrehur grackën për egërsirat. Dhe puna po i shkonte fort mbarë. Çdo dy tri dhelpëra i shikonte tek përpëliteshin mbi çark. Rrallëherë vinte duarbosh në shtëpi. Sajoi dhe një çapë[10] nga ato të gjuetisë, e stërviti mirë, si të thuash, e specializoi për gjueti dhelprash dhe ajo futej shpellë më shpellë e trazonte që andej dhelprat që binin shpejt në thesin e Hatës.U hiqte me kujdes lëkurën, i mbushte me kashtë, i thante në hije dhe sa i bëheshin dhjetë copë ngarkonte mushkën e vrap në pazarin e Shehrit, te Fike Terzija. Hatja i kënaqur e Fikja edhe më i kënaqur, i jepnin dorën njëri-tjetrit:

- Na shkoftë mbarë e hallall pazari!

Se sa dhelpra shiti Hatja, as vetë nuk e dinte, por, siç thoshin, me dhelprat e Hatës ngrohën qafën edhe zonjat e pashës së Stambollit. Të tjerë thoshin se Hatja i ra qarit me dhelpëra. Të tjerë thoshin se Hatja është burrë i zoti, se e kërkon paren gjer në gur të dhelprës. I çoi fjalë Kadës që të mos e priste Hatën as vitin tjetër, bile të kthehej edhe ai në shtëpi.

-Hajde, Kadë, se qari i madh paska qenë në Shumbat!

Dhe Kada u kthye, kur mori vesht se Hatja, kishte blerë një dyqan në Shehrin e Dibrës me ortak Fiken dhe shisnin gëzofë e antari që ua kishte zili tërë Rumelia. Ata jetuan gjatë qafë për qafe të dy, u bënë zengjinë të mëdhenj, me dyqane, toka e prona, por ama dhe Shumbatin nuk e harruan, vinin shpesh duke u kujtuar të tjerëve se qari i madh ishte në Shumbat.

-Vrej ktu, o voc! Qarit e mallit nuk i dihen rranjët...

U zgjata për të treguar se vendi ku lindi dhe u rrit Ilmi Lata, ku i ka mbetur " me duar në gji " familja, pa plëng e pa shtëpi, pa derë ku të trokasë për një copë bukë, është i harruar. Dhe po të mos kishte ndodhë që një plumb pistolete i një ushtari grek të mos kishte goditur në kokë e t'i kishte marrë jetën në moshën dyzet e pesë vjeçe Ilmi Latës, askush nuk do ta kishte përmendur. As media, as gazetat, as televizionet vendës e të huaj, as Ministria e Jashtme... As edhe deputeti i zonës z. Kaleci nuk do të ishte ngjitur në tribunën e parlamentit e të fliste duke e përmendur me emër e mbiemër.

Më erdhi mirë që për herë të parë pas kaq vjetësh dëgjova e lexova pjesë të një proteste të Ministrisë së Jashtëme Shqiptare për një ngjarje " në kufi ". Veçse, pasi e dëgjova dhe e lexova atë, ndjeva pak ftohtë, të ftohtë që më hyri në shpirt dhe më bëri të mendoja thellë. Në media flitet se Ilmi Lata kishte 15 vite që emigronte në vendin fqinj për të mbajtur me bukë familjen, se ishte baba i 5 fëmijëve dhe la pas një gjendje të mjeruar ekonomike, se kishte marrë para borxh për tu nisur për në Greqi ku e priste i biri i tij 16 vjeçar edhe ai emigrant në Greqi, se ai e bënte 2 – 3 herë në vit rrugën për në Greqi...

Këtë detaj tragjik të jetës së Ilmi Latës nuk e dëgjova e lexova të përshkruhej as në komunikatën e Ministrisë së Jashtëme dhe as në prononcimin publik në Kuvend të deputetit të së djathtës shqiptare në Dibër.

Ky nuk është një detaj i veçantë i një njeriu të veçantë, nuk është vetëm i Ilmi Latës nga Luznia por i dhjetëra mijëra " Ilmi Latave " nga e gjithë Shqipëria.

Ai ishte baba i pesë fëmijëve. Atë e priste një djalë 16 vjeç (një fëmijë që është dislokuar diku në hapësirën greke për të punuar për bukën e vëllezërve dhe motrave të veta, për veshjen dhe mbathjen e nënës së tij !!!???).

A ka moment më tragjik se ky për jetën e një brezi që vjen e hynë në jetë "për bukën e gojës" në vend që të hyjë për " bukën e dijes " !?

Ilmi Lata kishte 15 vite që shkonte e vinte në Greqi " 2 – 3 herë në vit ". Ilmi Latës i bie që gjatë këtyre viteve të ketë bërë 30 – 40 udhëtime maleve për të punuar për disa muaj e për tu kthyer për disa ditë tek familja për " drutë dhe zahirenë e dimrit "! ...

Në botë ka lloj - lloj rekordesh " ginis ", të të gjitha llojeve e ngjyrave deri tek ai se kush ha më shumë sandviçë në një njësi kohe të caktuar. Ilmi Latës i takon një rekord i tillë, i takon të shkruhet në librin e rekordeve të " udhëtimeve të dhimbshme të jetës ". Por ajo që i takon atij dhe pushtetit e shtetit zyrtar në Shqipëri është fakti se ky njeri që ka punuar e jetuar për pesëmbëdhjetë vjet rrugëve të vështira të kurbetit duhet të ishte trajtuar si emigrant, duhej që ai dhe fëmija e tij duhet të ishin legalë, njerëz që me djersë dhe gjak i jepnin jetë punës dhe jetës në fqinjin tim jugor.

Fakti që në Greqi ka një numër të madh emigrantësh pa dokumente, faktet se shteti grek vazhdon t'i trajtojë emigrantët si peng, si skllevër të punës së zezë, t'i rrahë, t'i torturojë (kujto skandalin e publikuar pak ditë më parë), tu grisë pasaportat, t'i urrejë dhe t'i vrasë, duhet të kishte tërhequr me kohë vëmendjen e shtetit dhe pushtetit në Shqipëri.

Fakti që Shqipëria edhe pas shtatëmbëdhjetë vjetësh i përcjell djemtë dhe burrat e saj me qefin në kokë deteve dhe maleve dhe rrjedha e gjakut të ri shqiptar formon lumë, duhet të kishte shqetësuar si të majtën po ashtu edhe të djathtën shqiptare në ngjitjet dhe zbritjet në karriget e shtetit dhe të pushtetit.

Ministria e Jashtëme e Shqipërisë, me zë të ulët, lutës, lypës, më në fund e tha një fjalë. E tha nëpër dhëmbë, nuk e dëgjoi kush, nuk e dëgjoi as ajo vetë.

Deri kur shqiptarët do të jenë peng të një shteti, të shtetit të vet pa sy, pa veshë e pa zë ?

Deri kur shqiptarët do ta kërkojnë bukën thatë në vende të tjerë nën shënjestra pushkësh të vendeve të tjerë?

E-mail: a_ashiku@yahoo.gr
00306938103747.

SQARIM: Disa emra të veçantë (antroponime), që i kemi përdorë shpesh në tregimet tona, me përparësi për të evidentuar vlerat semantike të të folmes së Dibrës, shprehin një tendencë të kahershme në përdorimin e tyre të shkurtuar, të parapëlqyer për t'u dhënë rëndësi personazheve, origjinës së tyre, mjedisit ku veprojnë, kohës, personalitetit të tyre. Janë emra njërrokësh që shquhen si emrat femërore; Met-Meta, Dikë-Dika, Cen-Cena ose emra që mbarojnë me e të patheksuar, Lame-Lamja, Hate-Hatja, Fike-Fikja, etj.

Shpjegime fjalësh e shprehjesh:

1-Tahaj, nij ktu, o voc – tani dëgjo këtu, o djalë!
2-Kujkuq (kunjkuq) - quheshin ushtarët turq që mbanin në kokë një kësulë të gjatë, si kunj, me ngjyrë të kuqe, kësulëkunj, kujkuq (kunjkuq)/
3-Bënë bilik – hodhën shtat, u rritën, u bënë për punë, për të fituar.
4-Antari-a, të, emf. – veshje si një jelek i gjatë, i qëndisur, që mbahej sipër rrobave të tjera nga gratë zakonisht, por edhe nga burrat kur ishte prej leshi.
5-Muslluk-u,-qe, -et.- enë prej teneqeje që përdorej për të mbajtur ujët, një lloj legeni me lëfyt.
6-Xhemile-hanëmen-Xhemile zonjën, hanem-hanemja-zonjë, kështu thirreshin në familjet e pasura qytetare gratë nga burrat e tyre, por edhe nga të tjerët në shenjë respekti për to.
7-Çarshi-a, të, emf.-treg i mbuluar, dyqane në dy anët e një rruge.
8-Çark,-çarqe-kurth, një lloj mekanizmi për të kapur në grackë kafshët e egra, ndërtohej prej druri a prej hekuri.
9-Parllak-u, qet, em.- mbetje, shenje nga një kafshë e dëmtuar prej egërsirave që vërteton kafshën e humbur.Parllak coftinë-mbetje nga një kafshë e ngordhur.Bariut që i humbiste një kafshë duhej të sillte e të gjente patjetër parllakun, ndryshe paguante disa fish kafshën e humbur.
10-Çapë-a, at, emf. Zagar gjuetie, zakonisht një zagar i vogël që stërvitet për gjueti shpendësh, lepujsh, dhelprash, etj.

AGRON TUFA

DIMRI NË DIBËR

Në kujtim të të ndjerit, kushëririt H. Z

Me ndryshqe muzgjesh dhe kujën e erës
dimri dibran i avitet katundit;
dhe dielli then qafën mrrolun prej mnerës
si dezertori i fundit.

Vargmalet e Korabit në lindje struken
pështjellë me tambare mjegullash mitike
që vrundull shtjellen kah qielli e duken
si bombë atomike.

Pamja përposh, me fshatrat si zgjonj,
me tymtarë të menduar çative -
i grish çamarrokët e verdhë si ftonj
brenda shtëpive.

Amvisa shtron darkën e varfër, pa fjalë,
shtron shtrojet për pleq e fëmijë,
e jashtë rrëfen me valë e stërkalë
Drini i Zi -

të njëjtën përrallë, monotone, të gjatë,
pa as dhe një fjalë të ndryshuar:
"Lumni e zi ke binjakët në shtrat
që flenë qafuar...!"

"Dalç fare Drin' i Zi! T'u thaft' goja plakush!"
mallkon amvisa me mendjen tek burri.
Po askush nuk i thotë: "Ke mbetur vejushë -
vejushë prej qëkuri!"

Askush s'do ta dijë atë natë, pa ispatë;
as pleqtë, as nusja, binjakët:
sall shpirti gjithë pezm gjakon nëpër natë
trajektoren e largët -

me kumtin se burri, babai, vonon,
se ndoshta s'do shihen më soje -
se kockat Otranto përditë ia hollon
si gurë dominoje.

Por, ah, mor Zot, nuk mbërrika në Dibër,
dhe mbetka vjerrë kjo breng' e vdektarëve!
Veç ernat çatajtë si bishat në dimër
ua ngulin mullarëve -

dhe sulen tërbim në pullaz, dritare,
si Shiva të kota, të etura për shpagë,
si Erini absurde që duan hakmarrje
pa patur një shkak.

Kur zë agsholi të zdritet konturesh
dhe hapet fashë bunacë e pazë -
dhëmbët e thyer të erës pas muresh
i mbledh një nga një;

dhe teksa mes gishtash i sjell këto presa,
kobi amvisën godet si me kazëm,
dhe kutull i shuket në grykë dënesa -
gropa në parzëm;

dhe kap atë kumt që ernat e shprishën,
çka Drini pat folë me gjuhë Ezopi,
çka fsheh i shuar ekrani përzishëm
si sy Ciklopi;

atë që binjakët në gjumë, kruspull -
dy luleshtrydhe korijes pa cak -
do zgjohen jetimë. Dhe hija, si turtull
u shket në gjak;

atë që k'soane hedh shtat dhe mbush
ditët, - vargan qiparisash ndër varre -
dhe fatin e saj, të mbetur vejushë
njëzetë vjeçare.

Po kurmin e bukur - lulëkuqen e pamort,
këputur me drapër dallgësh, a thua
ka det që e kalb? Ah, merre o Zot
në Ahiret e tua!
.....

Pasdite grahën gjithë ernat e dimrit
me dhurata të bardha prej qiejsh virgjinë...
Dhe gjithë sa ha shigjet' e vështrimit -
pështjellë në qefinë


bornajash sterile – nga mali në mal.
Po dimri në Dibër të bardhë ka fishekët -
anestezinë e ngushëllimit, vetminë, melekët
e kallur në fjalë...

Marrë nga vëllimi "Fryma mbi ujëra"

"Ata erdhën nga Stebleva...!"

Ing. **Eduart Abazi**

Në një kohë relativisht të shkurtër, pas botimit të suksesëshëm të librit poetik "Dashuria është kudo..!", autori Kujtim Boriçi del para lexuesve me librin tjetër "Ata erdhën nga Stebleva.."(1), tashmë në një zhanër tjetër, në fushën e publiçistikës. Janë mbi 30 shkrime publicistike të përzgjedhura nga karriera e tij e gjatë mbi tre dekada si gazetar, një pjesë e vogël e të cilëve janë publikuar në shtypin qendror të kohës, ndërsa pjesa tjetër e shkruar enkas për këtë libër, mbi një synim të caktuar e me kërkesa rigoroze profesionale në këtë fushë. Duke parathënë që në fillim se ky libër, që në pjesën më të madhe të tijë përmbanë përjetime, përshkrime, portrete personazhesh e evenimeeente të Steblevës, Gollobordës e njerëzve të saj, por dhe më gjerë, për mua si intelektual i asaj zone, e njëkohësisht si redaktor i librit, është krejt i veçantë. Së pari, ndonëse në 'të përfshihen reportazhe, portrete, intervista, refleksione, shënime udhëtimi, deri dhe Dossier, i gjithë libri kërkon një harmonizim deri në detaje-sion të pjesëve përbërëse të tij, gjithmonë në funksion të pasqyrimit të realitetit, të ngjarjeve e fenomeneve të veçanta e shumëdimensionale nëpërmjet gërshetimit të faktit historik të dokumentuar, përjetimeve të vetë protogonistëve të evenimenteve, e deri dhënia me racionalizëm e asaj që vetë Kujtimi si autor ka përjegtuar nga studimet, ngjarjet, njerëzit e fenomenet për të cilat shkruan. Së dyti, duke njohur e zotëruar mirë objektin për të cilin shkruan, ja ka arritur që me finesë të gjejë të veçantën, thelbin e mesazhit që do të evidentoj e të transmetoj tek lexuesi. Së treti, në kompleks, shkrimet që trajtojnë Steblevën e Gollobordën, të marra në tërësi, japin një tabllo shumëdimensionale, ku gërshetohet tradita e vyer e kësaj treve, madhështia e personaliteteve të njohura që ende rrinë në "pluhurin e kohës", lidhjet e ngushta të banorëve me vendlindjen, ndershmëria, fisnikëria e bashkëjetesa, vlerat e pasura kulturoro-artistike të përcjella brezave e të pasuruara nga brezi në brez, deri dhe tek tradita e pa cënuar e banorëve të kësaj treve për t'ë mos u bërë kurrë pjesë e së keqes, por të qënit gjithmonë në krahun kundërshtar të saj. Për këto e shumë të tjera dëshmi e mesashe që sillen në librin "Ata erdhën nga Stebleva!", për mendimin tim, ky botim sjellë diçka që mungonte, atë që megjithë përpjekjet, nuk e kanë sjellë në këto përmasa e në këto parametra botime të veçanta për zonën tonë, të publikuar deri tani. Së katërti, në këtë botim publicistik, fenomene e ngjarje që stonojnë me traditën e të mirën, nëpërmjet një sarkazme, deduksioni, krahasimi e deri elementë alegorikë, vihen në "shënjestër" si fenomene(jo bartësit që mund të jenë në çdo komunitet), duke tentuar në çdo rast tek apeli për neglizhimin deri në largim të plotë nga këto dukuri. Së pesti, autori, duke i qëndruar fanatik faktit, përjetimit direkt, duke përzgjedhur për të hedhur në letër esencialen, atë që e gjykon se duhet evidentuar për të qënë sa më mirë në funksion të mesazhit që do të japë, autori është bindës, e vështirë se të lë shteg kundërshtimi për atë e rreth asaj që shkruan. Së gjashti, një nga të veçantat e librit , që është dhe një nga meritat e autorit, për mua mbetet përfshirja në pjesën e dytë të botimit dhe të një cikli shkrimesh të përzgjedhura për njerëz, ngjarje e fenomene të shoqërisë shqiptare e më gjërë, jo si "garniturë", por si pjesë organike e një të tëre(librit), gjë e cila për lexuesin e çdo kategorie, krijon një konfiguracion, gjuhë të përzgjedhur një urë të plotë komunikimi ndjenjash e mesazhesh.



Mjeshtëri nga më të lartat e përzgjedhjes muzikore



Duke qënë shok i Kujtimit e në kontakt me krijimtarinë artistike e atë të përditëshme publiçistike, njëkohësisht redaktor së paku në tre librat e tij, në botimin "Ata erdhën nga Stebleva..!", mendoj se gjithkush, duke fletuar faqet e tij, do të konstatoj jo vetëm përgjegjësinë e të shkruarit nga autori, por dhe drama, ngjarje e fenomene që lidhen me Gollobordën e shtresa të shoqërisë shqiptare që ose nuk i ka njohur deri tani, ose nuk i ka "prekur", ndonëse mund të përballet me 'to vazhdimisht në çdo hap të jetës... Bie fjala, në shkrimin që hap librin e që është njëkohësisht dhe titull i tij "Ata erdhën nga Stebleva!", lexuesi njihet me një nga betejat më të vështira mes luftëtarëve vendas e pushtuesve sllavë, atë të Qafë-Shkallës , ku vetëm në momentin e fundit, kur kishte humbur çdo shpresë e pushtuesi po përparonte drejt Shqipërisë së Mesme, ardhja e luftëtarëve nga Stebleva(Klenja, Trebishti,Borova, Ostreni, Zabzunui, Okshtuni..), ndryshon fatin e betejës. E këtë dëshmi historike, autori e sjellë nëpërmjet dëshmisë së rregjistruar të shqiptares më të moshuar, Qerime Bardhit nga Llanga e Letmit(Librazhd), e cila ka qënë vetë protagoniste e kohës dhe e ka përjetuar këtë eveniment historik... Në një nga shkrimet e librit, në atë për Qytezën e Zabzunit, qytetin që dikur kishte 1200 shtepi, ku "macja kalonte nga çatia në çati", fatkeqësisht të lënë sot nën dhe', pa u eksploruar nga arkeologët, autori n'a sjellë një të vërtetë të pa njohur derri tani, faktin se si një nga intelektualët e njohur të vendit, me shqetësimin e ngritur nga intelektualë gollobordas, frenoi shkatërrimin e relikeve nga masakra e fortifikimit masiv në vitet '80-të... etj...

Në një farë mënyre, me një gjetje origjinale, me një këndvështrim të veçantë mbi ngjarje, histori e personazhe pa pretenduar të bëj historik apo të venitë a fabrikoj mite të pa qëna, libri është jo vetëm interesant, por dhe një tablo me vlerë për Steblevën, Gollobordën e njerëzit e saj. Jo vetëm për faktin se shkrimet e përmbledhura në këtë botim janë fare pak nga arshiva e pasur e autorit që shtohet çdo ditë, por veçanërisht talenti, puna e përkushtimi i Kujtimit, janë garanci se në të ardhmen e afërt, krijime të tilla e më të plota, do të jenë në dorë të lexuesit.

Kjo nuk duhej të ndodhte në Dibër

Bekim Çenga nuk jeton më. Një nënë mbeti pa djalë, një jetë e sapoçelur u këput në mes, një bangë në shkollat e Peshkopisë është bosh. Bekimin fëmijë e vranë në moshë fare të njomë. Kjo që ndodhi, nuk duhej të ndodhte në Dibër. Një krim i shëmtuar, një krim që mbushi për ditë me radhë faqet e shtypit shqiptar, një krim që tronditi opinionin qytetar. Në familjen e viktimës ishte dhe Presidenti i Republikës, zoti Bamir Topi, i cili u ndje prind. Ishte dhe kryetarja e Kuvendit, zonja Jozefina Topalli, dhe u ndje më shumë se nënë. Fjalët, në atë familje që humbën djalin në mënyrën më monstruoze, ishin të tepërta, por dhe heshtja aty flet. Heshtja flet se ky krim që ndodhi në Peshkopi mund të ndalohej. Ky krim i rrallë nuk duhej të ndodhte në Dibër. Atë ditë që përcollën Bekimin dhjetëvjeçarë në banesën e fundit, nuk ngeli sy pa u përlotur në qytetin e Peshkopisë. Dukej sikur dhe vetë blirët kishin ulur kokën. E kush mbeti pa e dënuar këtë krim monstruoz?

Mbarë opinioni shqiptar e dënoi. E dënoi edhe nëna e atij monstre që mbyti Bekimin. Bile, kërkoi nga drejtësia që djali i saj të varej. Por ajo la të kuptohej se vetë shteti dhe shoqëria janë fajtorë për këtë krim që ndodhi në Dibër.

Djali i saj shoqërohej me policë, gjykatës dhe prokurorë, sipas dëshmisë së saj.

Dhe këto i jepnin shpesh dhe çokollata. Krimineli asnjëherë nuk u veçua nga shoqëria dhe pse ai ishte i sëmurë mendor, edhe pse nëna e tij paguhej nga shteti për kujdesje të veçantë. Ai bridhte i lirë, bile dhe me armë, lozte dhe me fëmijët e qytetit, shkonte dhe tek shkolla. Të gjitha këto veprime të tij i dinin të gjithë, por kishin bërë syrin qorr e veshin shurdh. E krimineli arriti në atë që quhet krim monstruoz, krim i rrallë që nuk ka ndodhur në asnjë vend tjetër.

Vrau në mënyrën më barbare një fëmijë dhjetëvjeçar. La një nënë pa djalë, la një shije të hidhur në gjithë qytetin e Peshkopisë. Reagimi ishte i menjëhershëm i të gjitha instancave shtetërore, por vonë, tepër vonë.

Krimi ndodhi në Dibër, në ditën me diell. E kjo nuk duhej të ndodhte në Dibër.

Dibranët janë shquar gjithmonë për urti dhe mençuri, për besë dhe bujari. Në Dibër ka fituar përherë logjika mbi dhunën. Por ja që një krim monstruoz që tronditi opinionin qytetar ndodhi pikërisht në Dibër.

Krimineli ishte i sëmurë mendor dhe e dinin të gjithë. Ai ishte arrestuar disa herë nga forcat e rendit dhe gjykata e kishte liruar si njeri me të meta, por jo të dëmshëm për shoqërinë. Ishte i sëmurë dhe spitali nuk e shtronte në pavion që të mjekohej rregullisht. Në fakt e njhnin të gjithë si të tillë dhe prapë ai ishte i lirë. Ecte nëpër qytet si njeri normal, herë-herë dhe me armë, lozte me fëmijët dhe këto shoqëroheshin shpesh me të. Zbaviteshin policët me të metat mendore të tij (të paktën kështu shprehet nëna e tij). Dhe askush nuk e mendonte se një ditë, pikërisht ky që ishte adoleshent, në moshë (vetëm 19 vjeç) mund të bëhej agresor dhe të merrte jetë njerëzish.

Megjithatë, kjo ndodhi. Bekimi nuk kthehet më. Ndodhi ajo që nuk duhej të ndodhte në Dibër. Një nënë mbeti pa djalë, një jetë e sapoçelur u këput në mes, një bangë në shkollë mbeti bosh.Aty përherë ka lule dhe vetëm lule. E kanë vështirë dhe nxënësit, shokët dhe shoqet e Bekimit të pafajshëm të hedhin sytë mbi libra dhe fletore kur shikojnë bangën e tij bosh. E Peshkopia nuk e kalon lehtë këtë që ndodhi. Do ta kujtojnë të gjithë këtë krim si diçka të tmerrshme dhe të vetëm që ndodhi në këto vite në Dibër.

Shaqir Skarra

"Zaya" ekspozon pikturat në Muzeun Kombëtar

Me date 23 nentor 2007, ne Muzeun Historik Kombetar, piktori dibran Zaim Elezi "Zaya" hapi ekspoziten e tij personale.

Zaim Elezi eshte lindur ne Diber ne vitin 1958. Ne vitin 1983 mbaron studimet e larta ne akademine e arteve, Tirane. Zaim Elezi ka punuar si piktor filmi ne TVSH; skenograf i teatrit profesionist, Peshkopi; mesues ne shkollen e mesme artistike, Peshkopi; drejtor artistik ne sh.p.k. "Pekomeri", studione artit "Zaya", etj.

Ka marre pjese ne ekspozitat kolektive te mbajtura ne Peshkopi e Tirane qe nga viti 1984-1990; ekspozita kolektive ne Prishtine (1999), Annemasse-France (2004), ekspozite me rastin e 600 vjetorit te Lindjes se Heroit Kombetar Gjergj Kastrioti Skenderbeu, ne Tirane e Prishtine (2005), etj.


Ne vitin 2004 ka hapur nje ekspozite personale ne OBT, Gjeneve, Zvicer.

Shume prej pikturave te tij jane pjese e koleksionisteve me fame ne France, Kanada, Angli, Zvicer, Amerike. Gjithashtu, shume dashamires te piktures ne Shqiperi mbajne ne koleksionet e tyre piktura te firmosura "Zaya".

Ekspozita me pikturat e "Zaya"-s do të qëndrojë e hapur çdo dite nga data 23 nentor 2007 deri me 3 dhjetor 2007.



"Ftonjtë" - Zaim Elezi "Zaya"



"...Romani "Dueli" i Agron Tufës është një nga krijimet më të bukura që më ka qëlluar të lexoj këto dhjetë vjetët e fundit të postkomunizmit".

ISMAIL KADARE

"I jemi mirënjohës Servantesit të madh për thyerjen magjistrale që i ka bërë skenës së marrëdhënieve të ngurta midis dhunuesit, viktimës dhe dalëzotësit.Pa e mohuar realitetin e skemës së mësipërme, duhet thënë se marrëdhënia në fjalë është shumë më e gjerë se kaq...Mendoj se duhet t'i jemi shumë mirënjohës edhe shkrimtarit me talent krejt të veçantë Agron Tufa, sepse në romanin e tij të mrekullueshëm "Dueli", na paraqet estetikisht një spektër shumë të gjerë dhe të ndërlikuar marrëdhëniesh midis dhunuesit, viktimës dhe mbrojtësit të saj, që i ka munguar mizorisht jo vetëm letërsisë shqiptare, por dhe kujtesës sonë kolektive që ka qenë shpesh e ideologjizuar"

ARTAN FUGA

"Qysh në shfletimin e faqes së parë të romanit "Dueli" përsëritet befasia e këndshme e ballafaqimit me një tjetër mjeshtër të fjalës dhe të mendimit, i cili shkruan krejt ndryshe, por me një përsosje artistike të admirtueshme"

ABAZ VEIZI

Cikël me poezi nga
QAZIM HATA

Shumbati

Shumbati i lashtë sa dhe toka
I thinjur nga kohrat
I lodhur nga sundimet
I sfilitur nga nga mjerimi
I përgjakur nga nga luftërat.
Vend i mistereve të mëdha
Vend i heronjëve të fjetur
Vend i dashurive të vrara
Vend i legjendave të gjalla
Vend i bukurive të rralla.
Këtu flasin edhe varezat
Këtu rriten dhe lule të bardha
Madje tregohen dhe shumë përralla
Këtu bën shumë dimër
Stinët thua se janë të njëjta
Këtu e bukur është lindja
Tragjike është vdekja
Këtu këndohet më dhimshëm se kudo
Këtu flitet dhe pa folur.
Era fryn dhe në verë
Në pyll ka mjaft ujqër
Jo pak ka dhe lepuj
Thëllënzat gati janë zhdukur
Pëllumbat ka kohë që s'duken
Këtu ëndrat mbetën ëndrra.
Shpresat mbetën shpresa.
Këtu dhimbja shumfishohet
Këtu ëmbël fëshfërin gjethja.
Këndshëm këndon bilbili
Krenar ecën dhe kali
Këtu është engjëlli, këtu është djalli.
Këtu është shpirti, këtu është malli.

Van Gogut

Veshi i prerë
Sinjal dashurie
S'mund t'i dhurosh
Tjetrit dashuri
Pa i shkaktuar
Vetes dhimbje.

Kur qajnë gratë

Kur qajnë gratë
Tremben burrat
Se mos thyhen
Kur qajnë burrat
Tremben malet
Se mos shemben
Kur qajnë malet
Ah, kur qajnë malet!

Dashuria u plak

U lodhëm nga paqja
Na teproi lufta
Fjala humbi çdo kuptim
Dashuria u plak
Kotësia u ringjall
Mjergull, pluhur, harrim
A e ndjeni, vjen era tym?

Ti do vish

Ti do vijsh dhe unë të pres
Siç pret toka diellin në mëngjez
Hënën merre nën sqetull
Kujtimet spërkati me vesë
Ti do vijsh dhe unë të pres.
Shpirt valë tek puthja e parë.

Ditë shiu

Shiu troket në dritaren time me tërbim
Qielli përtej saj është nxirë sterr
Unë biri i kësaj toke jam tredhur në mendime
Sa e lashtë kjo botë e shkretë duhet të jetë?
Dhe mendimet ngasin njeri tjetrin
E shkojnë tutje në lashtësi
Atje ku mori udhë njerëzimi
Kur Adami puthi Evën kush e di?
Qe ditë me diell apo shi?

FTESË PËR BASHKËPUNIM

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për çdo lloj bashkëpunimi.
Të Interesuarit mund të sjellin opinionet e tyre për çeshtje e probleme të ndryshme që shqetësojnë Dibrën e dibranët.
Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.
Redaksia kujton bashkëpunëtorët se dorëshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet.
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179 / 233 283
Email: lid_gazeta@yahoo.com

Gazetën, falë ndihmës së z. Gazmend Kërkuti, mund ta lexoni edhe në internet në adresën: www.dibra .org

THIRRJE

ES-SELAMU ALEJKUM UE RAHMETULL-LLAHI UE BEREKATUHU

Të nderuar besimtarë dibranë!

Ndërtimi i xhamisë së re po përfundon. Sponsorizues Gani Abdul Naser ka investuar vetëm ndërtimin e objektit. Xhamia do të ketë: Medrese, bibliotekë, sallë kompjuteri, zyra si dhe salla për takime, simpoziume e mbledhje.

Pajisjet e këtyre ambienteve janë të domosdoshme prandaj kërkojmë mndihmën tuaj për t'i plotësuar me tapete, tavolina, karrike, perde, aparate foto-kopjeje, televizor etj.

Për këtë punë është ngritur një komision i përbërë nga besimtarë të besuar dhe të sinqertë: Muis Kurtulla, Mefat Shehu, Muhamet Shehu, Ylber Torba, Mendu Lusha, Albert Kojku, Shukri Torba, Halil Gazidede, Avni Gazidede, Ajet Çipuri, Sakip Rama dhe Osman Xhili.

Lekët do t'i dorëzohen vetëm Administratorit Mefat Shehu i cili do të japë mandat-arkëtimin me numër date e vulën e Myftinë Dibër.

Lekët mund të derdhen edhe në numrin e llogarisë të myftinisë Dibër 0002725076 në Raiffeisen Bank Peshkopi. Me titull për "Xhaminë e re".

Emrat e kontribuuesve do të afishohen në xhaminë e vjetër, dhe do të jepen dhe në Televizionin "Dibra Vizion".


Myftinia do t'u informojë për çfarë janë shpenzuar këto të ardhura.


"Ndihma për xhamitë, çezmat, rrugët etj., bëhen siguri për personat që japin".

Kjo ndihmë kurrë nuk e pakëson pasurinë tuaj, por e shton me dhjetëfish.

Es-Selamu alejkum
Myftinia Dibër

BOTIME TË REJA TË AUTORËVE DIBRANË





Grafika: **Studio "m&b"**. Tel: (04) **233 283**. Shtypur në shtypshkronjën "**Dita 2000**". Tel: (04) **273 745**

www.dibra.org

JETO PRANE DIBRES